FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 109

Tiranë – E premte, 26 korrik 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 85/2019, datë 18.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	8105
Vendim i Kuvendit nr. 86/2019, datë 18.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar.....	8131
Dekret i Presidentit nr. 11233, datë 22.7.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	8131
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 499, datë 2.7.2019	Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike.....	8132
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 22.7.2019	Për përcaktimin e metodologjisë për vlerësimin e kritereve të konkurrimit publik për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private.....	8138
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 274, datë 19.7.2019	Për delegimin e kompetencave për miratimin e shërbimeve, trajnimeve, *workshope*-ve jashtë vendit, për nëpunësit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë.....	8140
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 436, datë 26.7.2019	Për delegim kompetencash.....	8140
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 90, datë 16.7.2019	Ndihma shtetëror "Fondi grant 'Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve' të bashkisë Tiranë"'	8141
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Elmaz Ramaliu.....	8142

VENDIM
Nr. 85/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shtohet kreu a/I me këtë përmbajtje:

"KREU a/I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni a/1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vijim Kuvendi, për organet drejtuese, mbledhjet e komisioneve dhe seancave plenare, procedurën ligjvënëse, kontrollin parlamentar, monitorimin e procesit për integrimin evropian, zgjedhjen/emërimin/shkarkimin e organeve kushtetuese dhe të institucioneve të krijuara me ligj, interpretimin dhe ndryshimin e rregullores, imunitetin parlamentar, transparencën dhe shërbimet e Kuvendit.

2. Kodi i Sjelljes së Deputetëve është pjesë e rregullores.

Neni a/2
Stema, vula dhe logoja e Kuvendit

1. Kuvendi përdor stemën e Republikës së Shqipërisë dhe vulën zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Logoja e Kuvendit përdoret në mjediset e Kuvendit në dokumente e akte të brendshme, në korrespondenca të deputetit me të tretë, në botime e publikime ose në veprimtari, të cilat organizohen nga Kuvendi.

3. Logoja e Kuvendit dhe rastet e detajuara të përdorimit të saj në dokumentet e brendshme të Kuvendit, si dhe në veprimtaritë parlamentare miratohen me vendim të Byrosë.

Neni a/3
Selia e Kuvendit

Selia e Kuvendit është në Tiranë.

Neni a/4
Mbledhjet jashtë selisë

Kuvendi ose organet e punës së tij mund të mbajnë mbledhje edhe jashtë selisë së Kuvendit. Konferenca e Kryetarëve cakton vendin kur mbledhja e Kuvendit bëhet jashtë selisë, ndërsa për komisionet/nënkomisionet parlamentare, vendi caktohet nga kryesia e komisionit.".

Neni 2

Titulli i kreut I të pjesës së parë ndryshohet si më poshtë:
"Konstituimi i legjislaturës së Kuvendit".

Neni 3

Në nenin 4, "Betimi i deputetëve", shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:
"6. Në këtë rregullore, termi "deputet" nënkupton çdo anëtar të Kuvendit, pavarësisht gjinisë.".

Neni 4

Në nenin 7, "Kryetari i Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, paragrafi i parë, fjalia "Përbërja e delegacioneve pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit dhe është në përputhje me rregullat e përfaqësimit në organizatat përkatëse" shfuqizohet.

b) Shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, përcakton anëtarësinë në grupet e miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga vetë anëtarët e Kuvendit.".

c) Shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

"5. Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, vendos për propozime të deputetit/deputetëve për të mbajtur heshtje solemne në seancë plenare.

6. Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime.".

Neni 5

Në nenin 8, "Byroja e Kuvendit", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Byroja e Kuvendit është organi vendimmarrës për aspektin administrativ dhe financiar të Kuvendit dhe organeve të tij. Byroja garanton respektimin e parimeve të pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare të Kuvendit si institucioni më i lartë përfaqësues e ligjvënës dhe që bazohet në parimin e ndarjes e të balancimit të pushteteve.".

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Byroja e Kuvendit përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët, sekretarët e sekretariateve dhe drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Përbërja e Byrosë së Kuvendit pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Një zëvendëskryetar duhet t'i përkasë partisë më të madhe të opozitës parlamentare.".

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Sekretariatet e Kuvendit

"1. Sekretariatet janë organe të Kuvendit, që mbikëqyrin punën e shërbimeve të administratës së Kuvendit për përmbushjen e detyrave të tyre në funksion të veprimtarisë së Kuvendit dhe të organeve të tij. Sekretariatet funksionojnë pranë Byrosë së Kuvendit.

2. Sekretariatet e Kuvendit janë: Sekretariati për Buxhetin, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, Sekretariati për Statusin e Deputetit, Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare, Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë, si dhe Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit.

3. Sekretariatet përbëhen nga tre deputetë, nga të cilët një sekretar dhe dy anëtarë. Sekretariati për Buxhetin përbëhet nga pesë deputetë, nga të cilët dy sekretarë dhe tre anëtarë. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën përbëhet nga pesë deputetë, nga të cilët një sekretar dhe katër anëtarë. Përbërja e tyre miratohet nga Kuvendi me votim të hapur, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimeve me kryetarët e grupeve parlamentare.

4. Sekretarët e Byrosë së Kuvendit drejtojnë sekretariatet e Kuvendit. Ata informojnë rregullisht Kryetarin dhe Byronë e Kuvendit për veprimtarinë e sekretariatit përkatës.

5. Rregullat e detajuara të funksionimit të sekretariateve miratohen nga Byroja e Kuvendit.".

Neni 7

Neni 10/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10/1
Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit

1. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, ndjek dhe mbikëqyr të gjitha procedurat e hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Kuvendit nga faza fillestare deri në propozimin e tij në Byronë e Kuvendit.

2. Sekretariati mbikëqyr administrimin e veprimtarisë së Kuvendit në aspektin financiar, në përputhje me buxhetin vjetor të Kuvendit, si dhe shqyrton realizimin faktik të buxhetit gjatë vitit të mëparshëm financiar.".

Neni 8

Pas nenit 10/1 shtohen nenet 10/2, 10/3, 10/4, 10/5 dhe 10/6 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/2

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

1. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare dhe shërbimet e Kuvendit lidhur me:

a) rendin e ditës së seancës dhe propozimet për ndryshime në të;

b) diskutimet në seancë plenare dhe kohëzgjatjen e tyre;

c) çështjet e procedurës dhe replikën;

ç) votimin dhe sqarimin e votës "kundër";

d) garantimin e të drejtës për votim dhe paprekshmërinë e votës;

dh) verifikimin e kuorumit dhe të pjesëmarrjes;

e) shqyrtimin dhe votimin e akteve dhe amendamenteve në seancë në parim, nen për nen e në tërësi;

ë) ndjekjen e udhëzimeve të Kryetarit të Kuvendit/drejtuesit të seancës;

f) kryerjen e funksionit të komisionit të votimit në rastet e parashikuara në rregullore;

g) mbikëqyrjen e procedurës së zbardhjes së akteve të miratuara deri në firmosjen e arkivimin e tyre, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me transkriptimin e procesverbalit të seancës plenare;

gj) ndjekjen për zbatim të urdhrave dhe udhëzimeve të Byrosë.

2. Sekretariati shqyrton dhe vendos për kërkesat për marrjen e masës disiplinore, në përputhje me parashikimet e kreut "Rregulli dhe sjellja në Kuvend.

Neni 10/3

Sekretariati për statusin e deputetit

1. Sekretariati për Statusin e Deputetit ndjek dhe mbikëqyr punën e shërbimeve të Kuvendit për t'i mundësuar deputetit realizimin e detyrave dhe funksionit të tyre me profesionalizëm.

2. Sekretariati mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shërbimet e Kuvendit për statusin e deputetit, si dhe adreson problematikat e hasura në marrëdhëniet e deputetit me organet shtetërore qendrore dhe vendore mbi bazën e informacionit të marrë prej tyre.

Neni 10/4

Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare

1. Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare mbikëqyr organizimin dhe veprimtarinë e shërbimeve të Kuvendit për t'i siguruar deputetit produkte kërkimore parlamentare ose çdo informacion të nevojshëm për veprimtarinë parlamentare.

2. Sekretariati monitoron veprimtarinë e Bibliotekës së Kuvendit për pasurimin e fondit të saj me botime të reja.

Neni 10/5

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë ndjek dhe mbikëqyr shërbimet e Kuvendit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e marrëdhënieve me jashtë dhe diplomacinë parlamentare të Kuvendit, Kryetarit të Kuvendit, organeve të tij dhe raportimin e delegacioneve të përhershme në organizatat ndërkombëtare ose delegacioneve të përkohshme, në zbatim të kësaj rregulloreje, vendimeve ose udhëzimeve të Kryetarit apo Byrosë.

Neni 10/6

Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit

1. Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit ndjek dhe mbikëqyr punën e shërbimeve të Kuvendit të ngarkuara me garantimin e transparencës së veprimtarisë së deputetëve, komisioneve e shërbimeve të Kuvendit ndaj publikut dhe institucioneve.

2. Sekretariati mbikëqyr punën për aplikimin e përdorimit të teknologjive të avancuara të informacionit (*e-parlament*), për modernizimin e funksioneve të shërbimeve që ofron administrata, si dhe për mbështetjen e monitorimit të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj.

3. Sekretariati mbikëqyr punën për informimin e publikut për veprimtarinë e Kuvendit dhe

institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj.".

Neni 9

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11
Thirrja dhe kompetencat e Byrosë së Kuvendit

1. Byroja është organi që vendos për:

a) buxhetin e Kuvendit, sipas propozimit të bërë nga sekretarët për buxhetin dhe e përcjell atë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, për ta miratuar më pas në Kuvend;

b) ankimet në rastet e konstituimit të grupeve parlamentare;

c) ankesat e grupeve parlamentare për përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

2. Byroja e Kuvendit, në zbatim të kuadrit ligjor dhe në përmbushje të garantimit të pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare, harton rregulla të detajuara për:

a) pjesëmarrjen e deputetëve në veprimtaritë parlamentare;

b) trajtimin financiar të deputetëve dhe organeve të tij në përputhje me statusin ligjor të tyre;

c) mënyrën e funksionimit të sekretariateve të Kuvendit;

ç) statusin ligjor, trajtimin ekonomik dhe kriteret e punësimit të administratës së Kuvendit;

d) organizimin e strukturës së shërbimeve të administratës, sipas funksioneve kushtetuese që Kuvendi ushtron.

3. Byroja e Kuvendit shqyrton dhe vendos për ankimin ndaj masave disiplinore të parashikuara në këtë rregullore dhe për shkeljet e Kodit të Sjelljes, të dhëna nga drejtuesi i seancës ose mbledhjes së komisionit apo nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën.

4. Byroja e Kuvendit miraton:

a) raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit jo më vonë se data 31 mars të vitit pasardhës ose akte të tjera të veprimtarisë ekzekutive të Kuvendit;

b) raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje jo më vonë se data 31 mars të vitit pasardhës;

c) raportin vjetor të shkallës së zbatimit të rezolutave të Kuvendit për vlerësimin e veprimtarive të institucioneve kushtetuese dhe atyre të rregulluara me ligj të veçantë, jo më vonë se 15 muaj nga përfundimi i vitit për të cilin janë miratuar rezolutat;

ç) planet e veprimit ose dokumente të tjera për Kuvendin, në përmbushje të strategjive kombëtare ose rekomandimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare, që nuk janë objekt shqyrtimi dhe miratimi në seancë plenare apo anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare.

5. Kryetari i Kuvendit thërret mbledhjen e Byrosë së Kuvendit, sipas rendit të ditës të përcaktuar prej tij.

6. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretariatit për Buxhetin të Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.

7. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, emëron Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit sipas rregullave të përcaktuara të legjislacionit në fuqi.

8. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, miraton rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit.

9. Dokumentet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.".

Neni 10

Në nenin 12, "Konferenca e Kryetarëve", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Konferenca përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare ose në mungesë të tyre zëvendëskryetarët. Konferenca e Kryetarëve drejtohet nga Kryetari i Kuvendit, ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari, sipas rregullave të parashikuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje. Konferenca thirret nga Kryetari i Kuvendit ose me kërkesën e Këshillit të Ministrave apo të një prej kryetarëve të grupeve parlamentare. Në Konferencën e Kryetarëve merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin.".

Neni 11

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

1. Këshilli është organ këshillimor, i cili kryen funksione të vlerësimit ose të dhënies së mendimit për çështje të procedurave, që lidhen me funksionimin dhe vendimmarrjen e Kuvendit si më poshtë:

a) propozimet për ndryshimin e rregullores;

b) interpretimin e rregullores, sipas nenit 116 të saj;

c)) interpretimin e Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit të Kodit të Sjelljes, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Sjelljes në këtë rregullore;

ç) mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve të Kuvendit;

d) vlerësimin periodik dhe rishikimin e Kodit të Sjelljes në rastet e parashikuara në Kodin e Sjelljes;

dh) çështje të tjera të parashikuara nga kjo rregullore.

2. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendit, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe pakicës parlamentare. Këshilli kryesohet nga Kryetari i Kuvendit.

3. Këshilli shqyrton rastet e pazgjedhshmërisë, sipas nenit 69 të Kushtetutës, si dhe bën verifikimin e mandatit të deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës kur krijohet vakancë, mbi bazën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit sipas nenit 70 të Kushtetutës.

5. Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, ose heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ose ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti në përputhje me nenin 73 të Kushtetutës. Shqyrtimi i kërkesës bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenet 118 dhe 119 të kësaj rregulloreje.

6. Këshilli mblidhet me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose 1/2 së anëtarëve. Rendi i ditës caktohet nga Kryetari. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

7. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i paraqet Kryetarit raportin, i cili përmban të gjitha qëndrimet për çështjen. Raporti i përcillet seancës plenare brenda dy javëve nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes. Raporti paraqitet nga relatori/relatorët.".

Neni 12

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Këshilli për Legjislacionin

1. Këshilli është organ këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

2. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë më parë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Këshilli siguron përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit janë me profesion jurist ose të kenë përvojë legjislative.

3. Këshilli për Legjislacionin kryesohet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit, duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga shumica dhe një herë nga pakica parlamentare.

4. Komisioni përgjegjës, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, ose Kryetari i Kuvendit mund të kërkojë mendimin e Këshillit për Legjislacionin.

5. Këshilli shpreh mendimin bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose të komisionit përgjegjës.

6. Kryetari i Kuvendit, bazuar në kërkesën e paraqitur, përcakton rendin e ditës. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për

aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

7. Shqyrtimi i çështjes në Këshill dhe përcjellja e raportit komisionit përgjegjës bëhen brenda një kohe të arsyeshme, të harmonizuar me kalendarin e punimeve të komisionit përgjegjës. Në mbledhjen e Këshillit mund të marrin pjesë relatori i çështjes në komisionin përgjegjës dhe propozuesi i projektligjit. Nëse komisioni përgjegjës nuk merr parasysh mendimin e Këshillit, në raportin për seancën plenare paraqiten edhe argumentet e mospranimit. Raporti i Këshillit i bashkëlidhet raportit të komisionit.

8. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i paraqet Kryetarit të Kuvendit dhe/ose komisionit përgjegjës një raport ku pasqyrohen të gjitha opinionet për çështjen.

Kryetari i Kuvendit mund të autorizojë leximin e raportit në seancë plenare nga relatori ose relatorët kur ka më shumë se një mendim.".

Neni 13

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1
Delegacionet e përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare

1. Përbërja e delegacioneve të përhershme pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit dhe vepron në përputhje me rregullat e përfaqësimit në organizatat përkatëse.

2. Kryesia e delegacionit, brenda 10 ditëve nga mbarimi i veprimtarisë, i paraqet Kryetarit të Kuvendit dhe Sekretariatit të Marrëdhënieve me Jashtë raportin për mbledhjen ose veprimtarinë në organizatën përkatëse ku merr pjesë delegacioni. Përgatitja e raportit kryhet nga shërbimet e marrëdhënieve me jashtë nën mbikëqyrjen e kryesisë së delegacionit.

3. Sekretariati i Marrëdhënieve me Jashtë njofton Byronë e Kuvendit për marrjen e masave të nevojshme, në zbatim të angazhimeve të Kuvendit si rrjedhojë e pjesëmarrjes në organizatat ndërkombëtare.

4. Sekretariati i Marrëdhënieve me Jashtë harton një raport vjetor për veprimtarinë e delegacioneve të përhershme pranë organizatave ndërkombëtare, i cili miratohet nga Byroja e Kuvendit dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

5. Parashikimet në këtë nen zbatohen edhe për delegacionet e përkohshme, që përfaqësojnë Kuvendin në marrëdhëniet ndërkombëtare.".

Neni 14

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
Formimi i grupeve parlamentare

1. Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik. Formimi i grupit parlamentar i njoftohet Kuvendit në seancën më të parë.

2. Grupet parlamentare, sipas përkatësisë partiake, formohen mbi bazën e listës së partive politike që përfaqësohen në Kuvend, bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, të shpallur me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Grupet parlamentare, sipas orientimit politik, mund të formohen menjëherë pas konstituimit të Kuvendit ose gjatë legjislaturës, nga deputetë të pavarur, nga deputetë që largohen nga partia politike për të cilën kanë konkurruar në zgjedhje, nga deputetë që janë deklaruar jashtë grupeve ose kur krijohet një subjekt politik i ri.

4. Pas zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, drejtuesi i seancës lexon listën e partive politike që rezultojnë parti parlamentare, referuar vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, dhe fton deputetët që të plotësojnë deklaratën me shkrim për grupin parlamentar në të cilin do të bëjnë pjesë.

5. Brenda 5 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit ose e marrjes së mandatit gjatë legjislaturës, çdo deputet deklaron me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë ose deklarimin si deputet i pavarur ose jashtë grupeve parlamentare.

6. Grupi parlamentar formohet nga jo më pak se 7 deputetë. Çdo deputet mund të jetë anëtar vetëm në një grup parlamentar.

7. Kur numri i deputetëve të një grupi parlamentar bie nën numrin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, grupi pushon së ekzistuari.

8. Çdo deputet ka të drejtë të largohet nga grupi parlamentar. Deputeti i paraqet një deklaratë me

shkrim kryesisë së grupit parlamentar nga i cili largohet dhe Kryetarit të Kuvendit, i cili njofton në seancën më të parë. Deputeti që largohet nga një grupi parlamentar, mund t'i bashkohet një grupi parlamentar vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit.".

Neni 15

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 15/1
Deklarimi i pozicionimit politik të grupeve parlamentare

1. Kryetari i grupit parlamentar, brenda një jave nga formimi i grupit, dorëzon një deklarim me shkrim te Kryetari i Kuvendit për pozicionimin politik të grupit parlamentar "pro" ose "kundër" subjektit politik/koalicionit qeverisës, pasi merr miratimin me shkrim të subjektit politik/koalicionit qeverisës.

2. Nëse pozicioni politik i një subjekti politik ndryshon gjatë legjislaturës, ndryshimi dokumentohet nga një deklarim i ri, sipas rregullit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Kryetari i Kuvendit njofton në seancën më të parë plenare për çdo deklarim në lidhje me pozicionin politik.".

Neni 16

Në nenin 16, "Kryesia e grupit parlamentar", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Çdo grup parlamentar, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryesinë e tij. Kryesia e grupit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe/ose zëdhënësi. Në mungesë të kryetarit të grupit, ai përfaqësohet nga zëvendëskryetari."

b) Shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Grupet parlamentare miratojnë rregulloren e brendshme të organizimit të tyre.".

Neni 17

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 17/1
Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare

1. Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare merr pjesë në komisionet e përhershme, nënkomisionet, komisionet hetimore ose të posaçme me kërkesë të tij dhe miratim nga Kryetari i Kuvendit.

2. Deputeti i pavarur dhe/ose deputeti jashtë grupeve parlamentare ka të drejtë të marrë pjesë në grupet e miqësisë dhe delegacionet e përkohshme. Anëtarësia në grupet e miqësisë bëhet në bazë të përzgjedhjes së deputetit dhe me miratim nga Kryetari i Kuvendit, ndërsa pjesëmarrja në delegacionet e përkohshme bëhet me caktim nga Kryetari i Kuvendit.".

Neni 18

Në nenin 18, "Kompetencat e komisioneve të përhershme", shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"2. Në fund të çdo viti kalendarik, komisionet e përhershme paraqesin raportin vjetor të veprimtarisë parlamentare të tyre në një seancë plenare të veçantë. Raporti nuk është objekt diskutimi, me përjashtim të rasteve kur Konferenca e Kryetarëve vendos ndryshe.".

Neni 19

Në nenin 19, "Komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Integrimin Evropian të bëhet:

"Komisioni për Integrimin Evropian.

(Çështjet e integrimit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, si dhe monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian.)"

b) Shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"Në fushën e përgjegjësisë së të gjitha komisioneve parlamentare bëjnë pjesë edhe çështjet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të

Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.".

c) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Me kërkesë të kryetarit të komisionit të përhershëm dhe propozim të Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen nënkomisione për çështje ose detyra të caktuara, që lidhen me veprimtarinë e komisionit. Nënkomisionet mund të kenë jo më pak se 5 anëtarë, por jo më shumë se 9. Anëtarësia në nënkomision jo detyrimisht është e lidhur me anëtarësinë e komisionit të përhershëm brenda të cilit ngrihet.".

Neni 20

Në nenin 20, "Anëtarësia në komisionet e përhershme", shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Deputeti anëtar i komisionit për Integrimin Evropian është anëtar edhe në komisionet e tjera të përhershme.".

Neni 21

Në nenin 21, "Përbërja e komisioneve të përhershme dhe e nënkomisioneve të Kuvendit", pika 3 shfuqizohet.

Neni 22

Shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 21/1
Anëtarët zëvendësues

1. Kuvendi, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare, në seancë plenare, me votim të hapur, cakton për secilin grup parlamentar emrat e anëtarëve zëvendësues të komisioneve të përhershme, të nënkomisioneve, të komisioneve të posaçme, të komisioneve hetimore. Anëtarët zëvendësues për këshillat caktohen me urdhër të Kryetarit të Kuvendit.

2. Anëtari i një komisioni, nënkomisioni ose këshilli, në rast mungese ose pamundësie për të marrë pjesë në mbledhje, zëvendësohet nga një prej anëtarëve të caktuar në vendimin e Kuvendit ose në urdhrin e Kryetarit të Kuvendit.

3. Zëvendësimi bëhet me dijeninë e kryetarit të çdo grupi parlamentar.".

Neni 23

Në nenin 24, "Komisionet e posaçme", bëhen këto ndryshime:

a) Shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Nëse afati i veprimtarisë së komisionit të posaçëm përfundon dhe puna e tij nuk ka përfunduar ende, Kuvendi ka të drejtë të shtyjë afatin e veprimtarisë së tij bazuar në kërkesën e arsyetuar dhe vendimin e komisionit. Kërkesa i drejtohet Konferencës së Kryetarëve, jo më vonë se një javë para përfundimit të afatit, e cila, pasi e shqyrton, ia përcjell seancës plenare më të parë për votim.".

b) Shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Kur veprimtaria e komisionit të posaçëm ka për objekt përgatitjen e nismave ligjvënëse, kjo e fundit futet në rendin e ditës për shqyrtim në seancë plenare jo më parë se një javë nga dita e depozitimit."

Neni 24

Në nenin 26, "Programi i punës së Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Programi i punës së Kuvendit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve për një periudhë nga 3 deri në 9 javë, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pasi ka marrë më parë mendimin e anëtarit të Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin, të kryetarëve të komisioneve të përhershme dhe të shërbimeve në Kuvend. Në mbledhje merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave. Projektprogrami i punës u jepet anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve dhe anëtarit të Këshillit të Ministrave të paktën 4 ditë para zhvillimit të mbledhjes.".

b) Në pikën 6, në fund shtohet fjalia:

"Programi u shpërndahet deputetëve në seancë plenare dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit pas njoftimit/miratimit në seancë plenare.".

c) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Në programin e punës së Kuvendit futen automatikisht dekretet e Presidentit të Republikës, projektligje financiare ose ndryshimi i Buxhetit të Shtetit, projektligjet e propozuara nga deputetët, shqyrtimi i akteve normative me fuqinë e ligjit, ligjet e kthyera për rishqyrtim me dekret nga Presidenti,

propozimet për zgjedhje, emërim ose shkarkim drejtuesish dhe anëtarësh të organeve që zgjidhen nga Kuvendi, mocionet e kërkuara, çështjet që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme si dhe projektligjet ose projektvendimet e mbartuara nga programi paraardhës.".

Neni 25

Në nenin 27 "Kalendari i punimeve të Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në kalendarin e punimeve për çdo çështje shënohet komisioni përgjegjës që do të shqyrtojë çështjen dhe komisionet e përhershme që japin mendim.".

b) Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Kalendari i punimeve të Kuvendit përmban në mënyrë të detajuar kohën kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare dhe në komisione. Kalendari u shpërndahet deputetëve në seancë plenare dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit pas njoftimit/miratimit në seancë plenare.".

c) Shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1. Në kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit futen projektligjet/projektvendimet e përfshira në program, si dhe projektligjet e mbartura nga kalendari i mëparshëm, projektakte që propozohen nga komisionet e përhershme për procesin legjislativ, kontrollin parlamentar ose zgjedhjen/emërimin/shkarkimin e drejtuesve dhe anëtarëve të organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj, apo çështje që vlerësohen me prioritet nga Kryetari i Kuvendit dhe/ose Konferenca e Kryetarëve.".

Neni 26

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1
Rendi i ditës i seancës plenare

1. Rendi i ditës i seancës plenare përmban çështjet që janë parashikuar në kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit dhe që kanë përfunduar shqyrtimin në komisionet parlamentare.

2. Për çështje të tjera, të parashikuara në këtë rregullore, por që nuk janë pjesë e kalendarit, Kryetari i Kuvendit dhe/ose Konferenca e Kryetarëve miratojnë një rend dite të veçantë.

3. Rendi i ditës miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare.".

Neni 27

Në nenin 28, "Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës "dh". Projektligji që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar.".

b) Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar në programin 9-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendarin 3-javor të punimeve të tij.".

Neni 28

Në nenin 29, "Programi i punës dhe kalendari i punimeve të komisioneve të përhershme", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Çdo komision i përhershëm përcakton programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij. Si rregull, ata hartohen duke mbajtur parasysh programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit.".

b) Shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Komisionet e përhershme, gjatë periudhës njëmujore mund të miratojnë edhe kalendarë 1 ose 2-javorë për çështje të kontrollit parlamentar që nuk përfshihen në programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit. Kalendari 1 ose 2-javor përmban çështjet e programuara për shqyrtim nga komisioni.".

Neni 29

Në nenin 38, "Shqyrtimi i çështjeve", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në komisionin përgjegjës për shqyrtimin e çështjes caktohet relatori/relatorët e çështjes në përputhje me nenin 29, pika 2, të kësaj rregulloreje. Relatori/relatorët caktohen në mbledhjen ku miratohet programi i punës së komisionit dhe për çdo çështje që është në program. Mendimi i relatorit/relatorëve për çështjen duhet të jepet me shkrim dhe si rregull të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së caktuar për të shqyrtuar çështjen në komision. Në këtë rast, kryetari i komisionit thërret mbledhjen e komisionit në ditën më të afërt të mundshme.".

b) Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Në rast se komisioni përgjegjës miraton në parim projektligjin, ai fillon shqyrtimin dhe votimin nen për nen të tij. Për çështjet që propozohen për t'i kërkuar mendim Këshillit për Legjislacionin ose komisioneve të tjera, komisioni vendos me votim nëse duhet t'u dërgohen ose jo. Shqyrtimi i këtyre çështjeve kryhet pasi është marrë mendimi i Këshillit për Legjislacionin ose i komisionit të përhershëm. Për projektligjet që synojnë përafrimin, raporti i Komisionit për Integrimin Europian është i detyrueshëm për t'u shqyrtuar nga komisioni përgjegjës para miratimit në tërësi të projektligjit. Gjatë punës në komisionin përgjegjës, pjesa e raportit që ka të bëjë me përafrimin e legjislacionit dhe direktivave merret në konsideratë pa ndryshime.".

c) Shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1. Pas miratimit në tërësi të projektligjit, relatori/relatorët hartojnë raportin të cilin ia përcjellin komisionit përgjegjës dhe seancës plenare. Raporti përmban ndryshimet e miratuara në komision, si dhe rekomandimet për komisionin përgjegjës. Për hartimin e raportit relatori/relatorët mund të kërkojnë të ndihmohen nga specialistë të Këshillit të Ministrave të lidhur me çështjen, deputetët nismëtarë nga shërbimi juridik në Kuvend, si dhe nga ekspertë të tjerë.".

Neni 30

Në nenin 39, "Procesverbalet në mbledhjet e komisioneve", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Mbledhjet e komisioneve regjistrohen në mënyrë të plotë. Si rregull, për mbledhjet e komisioneve mbahet edhe procesverbal i përmbledhur.".

b) Në pikat 4 dhe 5 hiqet fjala "i përmbledhur".

Neni 31

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 39/1

Pezullimi i mbledhjes së komisionit

1. Në rast se në komision cenohet seriozisht rendi i punimeve, shkaktohet kaos dhe nuk merren parasysh kërkesat për mbajtjen e rregullit, drejtuesi i komisionit lë vendin e tij dhe mbledhja e komisionit quhet e pezulluar.

2. Në rast se pas rifillimit të mbledhjes kaosi vazhdon përsëri, drejtuesi i komisionit e pezullon mbledhjen për një periudhë kohe të caktuar ose e mbyll atë.

3. Kur një ose më shumë deputetë kërkojnë ndërprerjen e mbledhjes për shkaqet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin ta hedhë në votim këtë kërkesë.

4. Në rast mbyllje të mbledhjes, komisioni mblidhet në mbledhjen më të parë me të njëjtin rend dite.".

Neni 32

Në nenin 40, "Veprimtaria parlamentare", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë në seancë plenare, në mbledhjet e komisioneve/nënkomisioneve ose të këshillave, në veprimtari brenda ose jashtë vendit ose veprimtari në zonat zgjedhore, duke njoftuar më parë shërbimet përkatëse në Kuvend, si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet. Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e pjesëmarrjes së deputetëve në veprimtarinë parlamentare përcaktohen nga Byroja e Kuvendit.".

Neni 33

Shtohen nenet 40/1 dhe 40/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 40/1
Programimi i veprimtarisë parlamentare

1. Kuvendi zhvillon veprimtarinë parlamentare sipas rregullave të mëposhtme:

a) Ditën e hënë, si rregull, zhvillon veprimtari të grupeve parlamentare për t'u përgatitur për veprimtarinë gjatë javës në komisionet e përhershme parlamentare ose organet e tjera të Kuvendit dhe seancën plenare, sipas përcaktimit të bërë në kalendarin trejavor të punimeve të Kuvendit.

b) Ditën e martë dhe të mërkurë, si rregull, zhvillon veprimtari në komisionet e përhershme ose në organet e tjera të Kuvendit.

c) Ditën e enjte, si rregull, zhvillon punime në seancë plenare.

ç) Ditën e premte, si rregull, zhvillohet veprimtari e deputetëve dhe e grupeve parlamentare për njohjen e zgjedhësve me punimet e Kuvendit dhe për trajtimin e problemeve që kanë zgjedhësit në qarqe dhe zonat zgjedhore.

2. Programimi i veprimtarisë parlamentare, sipas pikës 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, zbatohet për tre javë të njëpasnjëshme kalendarike.

3. Java e katërt kalendarike është në dispozicion të deputetëve dhe grupeve parlamentare për veprimtari të përcaktuara në pikën 1, shkronja "ç", të këtij neni.

4. Kuvendi zhvillon punime në seancë plenare për diskutimin e çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit pasditen e ditës së hënë, që pason javën me veprimtari njohëse me zgjedhësit, sipas pikës 3 të këtij neni. Seanca plenare zhvillohet për jo më shumë se katër orë, ku koha e diskutimeve ndahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës, duke marrë parasysh edhe deputetin e pavarur ose deputetin jashtë grupeve parlamentare. Koha e diskutimit brenda shumicës ose pakicës ndahet për sa është e mundur në proporcion me madhësinë e grupeve dhe numrin e deputetëve të pavarur ose deputetëve jashtë grupeve parlamentare.

5. Rregullat e pikave 1-3 të këtij neni nuk zbatohen kur Kuvendi ka një çështje urgjente apo kërkesë për një projektakt me procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 40/2
Organizimet vullnetare në Kuvend

1. Deputetët mund të organizohen në grupe vullnetare parlamentare, duke deklaruar qëllimin/qëllimet që synojnë të ndjekin, grupet shoqërore që përfitojnë nga veprimtaria e grupit vullnetar, emërtimin që do të mbajë grupi dhe rregullat e funksionimit të tij.

2. Grupi vë në dijeni kryetarët e grupeve parlamentare dhe Kryetarin e Kuvendit për qëllimin dhe objektivat e veprimtarisë së tij. Kryetari i Kuvendit miraton me urdhër ngritjen e grupit vullnetar dhe e njofton atë në seancën plenare më të parë.

3. Pas konstituimit, grupi vullnetar parlamentar zgjedh kryetarin, kryesinë, si dhe miraton rregulloren e brendshme të tij.

4. Brenda 30 ditëve nga konstituimi, grupi vullnetar paraqet në Konferencën e Kryetarëve kalendarin e veprimtarive që planifikon të bëjë pjesë të veprimtarisë së Kuvendit. Pas miratimit, kalendari i veprimtarive të grupit, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

5. Veprimtaria e grupit vullnetar parlamentar mbështetet nga shërbimet e Kuvendit dhe për të lejohet përdorimi i logos së Kuvendit.".

Neni 34

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 41
Caktimi i specialistëve të jashtëm të përkohshëm

1. Komisionet ose këshillat mund të caktojnë specialistë/ekspertë të përkohshëm për realizimin e detyrave të tyre, kur Kuvendi nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për një çështje të caktuar.

2. Caktimi i specialistëve/ekspertëve të jashtëm të përkohshëm bëhet me vendim të Byrosë së Kuvendit, mbi bazën e propozimit të komisionit ose këshillit përkatës.".

Neni 35

Në nenin 44, "Fillimi i seancës plenare", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Në fillim të seancës plenare, drejtuesi i saj ose sekretari i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën njofton projektligjet e depozituara në Kuvend, dekretet e Presidentit, projektaktet e natyrave të ndryshme, propozimet për zgjedhje / emërim/shkarkim, pyetjet e kërkuara, interpelancat, kërkesat për mocion, mesazhet drejtuar Kuvendit, si dhe urdhrat e Kryetarit, vendimet e Byrosë së Kuvendit dhe të Konferencës së Kryetarëve.".

Neni 36

Në nenin 48, "Koha e diskutimeve", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Çdo deputet ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta, me përjashtim kur në rregullore parashikohet ndryshe. Deputeti nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër. Kur diskutimi është jashtë thelbit të çështjes, drejtuesi i seancës, kur çmohet prej tij, i tërheq vëmendjen deputetit dhe, nëse ai e përsërit, mund t'ia ndërpresë fjalën.".

b) Pika 2 shfuqizohet.

Neni 37

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 55
Kuorumi dhe vendimmarrja në seancë plenare

1. Kuvendi miraton ligje, vendime, rezoluta dhe deklarata.

2. Kuorumi për çeljen e votimit parlamentar është të paktën 71 deputetë.

3. Aktet e Kuvendit konsiderohen të miratuara kur për to kanë votuar "pro" shumica e deputetëve të pranishëm, me përjashtim të rastit kur kërkohet shumicë e cilësuar, sipas parashikimit në Kushtetutë ose në ligj.

4. Për përcaktimin e kuorumit dhe të shumicës së deputetëve, sipas parashikimit të pikës 3 të këtij neni, Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar.

5. Drejtuesi i seancës plenare, në leximin e rendit të ditës, i njofton Kuvendit edhe shumicën që kërkon votimi i çdo çështjeje të saj.".

Neni 38

Në nenin 57, "Votimi", pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Me fillimin e votimit nuk lejohen diskutime dhe nuk jepet fjala deri në shpalljen e rezultatit të votimit. Votimi nuk mund të ndërpritet për asnjë arsye, me përjashtim të rasteve kur kërkohet respektimi i dispozitave të rregullores lidhur me zhvillimin e votimi kur gjatë votimit vihen re parregullsi në procedurën e votimit ose probleme teknike në funksionimin e sistemit elektronik të votimit. Byroja e Kuvendit përcakton modalitetet teknike të përdorimit të sistemit elektronik të votimit.".

Neni 39

Në nenin 58, "Votimi i hapur", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Votimi bëhet i hapur në rastet e miratimit të programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, të shqyrtimit të dekreteve të Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri, për kthimin për rishqyrtim të ligjit në Kuvend, të votimit të Buxhetit të Shtetit ose të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.".

Neni 40

Në nenin 60, "Votimi i fshehtë", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1/1, shfuqizohet.

b) Pika 4, ndryshohet si më poshtë:

"4. Fleta e votimit të fshehtë përmban të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit: "pro", "kundër" dhe "abstenim". Në fletën e votimit deputeti shënon me një shenjë të dallueshme dhe të qartë për zgjedhjen e bërë. Në rast se fleta e votimit përmban më shumë se një kandidat, deputeti vendos shenjën për zgjedhjen e bërë përbri emrave të vendosur në kuadrat.

Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose vota të pavlefshme.

Vota të vlefshme janë fletët e votimit në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërën nga alternativat.

Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fletës së votimit i mungon vula e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën ose nënshkrimet e tij;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime ose shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;

c) është votuar për më shumë se një alternativë;

ç) nuk është votuar për asnjë nga alternativat;

d) nuk është e qartë se për cilën alternativë është votuar;

dh) nuk është votuar për çështjen – objekt i fletës së votimit.".

c) Shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Byroja e Kuvendit përcakton modalitetet teknike të organizimit dhe zhvillimit të procedurës së votimit me kuti.".

Neni 41

Kreu IX, "Rregulli dhe sjellja në Kuvend", i pjesës së parë të rregullores, ndryshohet si më poshtë:

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 62
Rregulli dhe sjellja

1. Deputeti, gjatë ushtrimit të mandatit, respekton rregullat bazë për standardet e sjelljes, të parashikuara në këtë rregullore dhe në Kodin e Sjelljes së Deputetit.

2. Rregullat e përcaktuara në këtë krye dhe masat disiplinore zbatohen për shkeljen e rregullores dhe të Kodit të Sjelljes së Deputetëve.

3. Rregullat të parashikuara në këtë krye të rregullores dhe në Kodin e Sjelljes së Deputetit, për aq sa është e mundur, zbatohen për të gjitha organet e tjera të Kuvendit, si dhe për subjektet e mëposhtme:

a) Kryetari i Kuvendit;

b) Kryeministri;

c) anëtarët e Këshillit të Ministrave;

ç) drejtuesit/përfaqësuesit e institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj;

d) persona të tjerë të pranishëm në Kuvend.".

Neni 42

Pas nenit 62 shtohet neni 62/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 62/1

Shkelja e rregullave për parandalimin e konfliktit të interesave, parashikuar në Kodin e Sjelljes së Deputetit, trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.".

Neni 43

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 63
Masat disiplinore

1. Masat disiplinore që zbatohen ndaj deputetit janë:

a) tërheqje vëmendjeje;

b) vërejtje;

c) heqje e së drejtës së fjalës gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit;

ç) përjashtim nga seanca plenare/mbledhja e komisionit ose organi i Kuvendit;

d) përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/komisionet parlamentare dhe organet e Kuvendit deri në 10 ditë.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni, janë masa të lehta. Masat e lehta nuk ankimohen.

3. Masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni, janë masa të rënda. Deputeti ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë sipas rregullave të përcaktuara në këtë krye.".

Neni 44

Neni 64 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 64
Masa disiplinore e "tërheqjes së vëmendjes"

1. Masa disiplinore e "tërheqjes së vëmendjes" jepet në rastet kur:

a) deputeti përdor gjuhë joparlamentare, diskriminuese ose kryen veprime të tjera, të parashikuara në nenin 6 të Kodit të Sjelljes;

b) nuk paraqitet me veshje zyrtare, ose kryen një nga veprimet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 8 të Kodit të Sjelljes;

c) me sjelljen e tij pengon zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin;

ç) shkel rregullat për lobimin në Kuvend, të parashikuara në nenin 21 të Kodit të Sjelljes;

d) shkel rregullat për dhuratat dhe përfitime të tjera të ngjashme, të parashikuara në nenin 23 të Kodit të Sjelljes së Deputetit.

2. Masa disiplinore e "tërheqjes së vëmendjes" jepet nga drejtuesi i seancës plenare/mbledhjes së komisionit.

3. Në rast të shkeljes së parashikuar në pikën 1, shkronja "ç", të këtij neni, deputeti është i detyruar të marrë masa për të korrigjuar situatën e krijuar si pasojë e aktivitetit lobues të ndaluar. Në rast të përsëritjes, zbatohet masa më e rëndë disiplinore e parashikuar në nenin 65/1 të këtij kreu.

4. Kur shkelja e parashikuar në pikën 1, shkronja "d", të këtij neni nuk përbën vepër penale, deputeti është i detyruar të marrë masa për të korrigjuar situatën e krijuar. Në rast të përsëritjes, zbatohet masa më e rëndë disiplinore e parashikuar në nenin 65/1 të këtij kreu.

5. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga deputeti në seancë plenare/komision parlamentar, tërhiqen prej tij në po të njëjtën seancë/mbledhje komisioni dhe deputeti kërkon ndjesë publikisht për sjelljen e tij ose merr masa për të respektuar kodin e sjelljes, masa disiplinore e dhënë në zbatim të pikës 1 të këtij neni anulohet nga drejtuesi i seancës/komisionit.

6. Masa disiplinore e tërheqjes së vëmendjes ose anulimi i saj pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.".

Neni 45

Shtohen nenet 64/1 dhe 64/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 64/1
Masa disiplinore e "vërejtjes"

1. Masa disiplinore e "vërejtjes" jepet kur:

a) deputeti në të njëjtën seancë plenare/ mbledhje komisioni përsërit shkeljen e parashikuar në nenin 64, pika 1, të kësaj rregulloreje, pasi më parë i është tërhequr vëmendja;

b) deputeti cenon seriozisht rendin në seancë plenare/mbledhje komisioni;

c) deputeti zapton foltoren/mikrofonin dhe pengon deputetin e radhës të marrë fjalën.

2. Masa disiplinore e "vërejtjes" jepet nga drejtuesi i seancës plenare/mbledhjes së komisionit.

3. Masa disiplinore e "vërejtjes" pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 64/2
Masa disiplinore e "heqjes së të drejtës së fjalës"

1. Në rast se deputeti vazhdon të përdorë fjalë fyese, diskriminuese, të cenojë personalitetin e drejtuesit të seancës plenare/mbledhjes së komisionit, deputetëve, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, të ftuarve, personave të tjerë, ose kryen shkelje të tjera të parashikuara në nenet 64 dhe 64/1, pasi më parë, në të njëjtën seancë, i është dhënë masa disiplinore e "vërejtjes", sipas parashikimeve të nenit 64/1 të këtij kreu, drejtuesi i seancës e paralajmëron për "heqjen e të drejtës së fjalës".

2. Në rast se deputeti vazhdon sjelljen për të cilën është paralajmëruar, me urdhër të drejtuesit të seancës/komisionit i jepet masa disiplinore e "heqjes së të drejtës së fjalës" për seancën plenare/mbledhjen e komisionit për atë ditë. Deputetit nuk i jepet e drejta e fjalës gjatë gjithë kohëzgjatjes së seancës deri në mbyllje të saj.

3. Nëse drejtuesi i seancës plenare/mbledhjes së komisionit nuk konstaton ose nuk vepron me nismën e tij, çdo deputet i pranishëm ka të drejtë të informojë drejtuesin e seancës për të vepruar sipas pikës 1 të këtij neni. Drejtuesi i seancës/mbledhjes së komisionit shprehet menjëherë për këtë kërkesë.

4. Masa disiplinore e heqjes së të drejtës së fjalës pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes."

Neni 46

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 65
Masa disiplinore e "përjashtimit nga seanca plenare ose mbledhja e komisionit"

1. Masa disiplinore e "përjashtimit nga seanca plenare ose mbledhja e komisionit" jepet nga drejtuesi i seancës plenare/mbledhjes së komisionit kur:

a) deputeti vazhdon të mbajë të zaptuar foltoren/mikrofonin edhe pas dhënies së vërejtjes dhe paralajmërimit sipas nenit 64/2 të këtij kreu;

b) deputeti voton për të tretët në rastet e parashikuara në nenin 7 të Kodit të Sjelljes së Deputetit, ose pengon me çdo mënyrë deputetin të ushtrojë të drejtën për të votuar.

2. Në rast se deputeti nuk pranon të dalë nga salla ose përpiqet të hyjë në sallën e seancës plenare/mbledhjes së komisionit, drejtuesi i seancës plenare/komisionit i kërkon Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën marrjen e masës disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë".

3. Masa disiplinore e përjashtimit nga seanca plenare jepet nga drejtuesi i seancës/mbledhjes, si dhe shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me ndalesën e pagës së deputetit për atë ditë. Kjo masë publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.".

Neni 47

Pas nenit 65 shtohen nenet 65/1, 65/2, 65/3 dhe 65/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 65/1

Masa disiplinore e "përjashtimit nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë"

1. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë" i jepet deputetit:

a) kur edhe pas tërheqjes së vëmendjes dhe dhënies së vërejtjes nga drejtuesi i seancës/ mbledhjes, bën thirrje për përdorim dhune, pengon zhvillimin e rregullt të seancës plenare/mbledhjes së komisionit, shkakton kaos në seancë plenare/komision, fyen, kërcënon ose dhunon deputetët e tjerë, drejtuesin e seancës, anëtarët e Këshillit të Ministrave, të ftuarit ose persona të tjerë, apo përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës, Kryeministrin ose institucione të tjera shtetërore;

b) kur refuzon të dalë nga salla e seancës/mbledhjes, hyn ose përpiqet të hyjë në sallë përpara mbarimit të masës disiplinore të dhënë;

c) në rastet e ngacmimit seksual të çfarëdo forme, të parashikuar nga neni 10 i Kodit të Sjelljes së Deputetit.

2. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe nëse këto veprime kryen jashtë sallës së zhvillimit të punimeve të Kuvendit/mbledhjes së komisionit, por brenda mjediseve të tij.

3. Në rast se deputeti, ndaj të cilit është marrë masa e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, refuzon të dalë ose përpiqet të hyjë në sallën e seancës plenare/komisioneve përpara mbarimit të kësaj mase disiplinore, afati i masës dyfishohet.

4. Kërkesa për marrjen e një mase të tillë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqitet me shkrim nga jo më pak se 7 deputetë ose nga drejtuesi i seancës plenare/komisionit, nga personi viktimë e ngacmimit seksual dhe jo më vonë se 24 orë nga dita e seancës plenare/mbledhjes së komisionit.

5. Kërkesa për rastin e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni paraqitet nga personi/viktimë e ngacmimit seksual.

Neni 65/2
Shqyrtimi dhe marrja e vendimit nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

1. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë" jepet nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Mbledhja e Sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës.

2. Shqyrtimi i çështjes kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton të drejtën e deputetit për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për t'u njohur me provat dhe dokumente të tjera.

3. Seancat e shqyrtimit të kërkesës për shkelje të nenit 10 të Kodit të Sjelljes së deputetit, zhvillohen

duke ruajtur sensibilitetin dhe jetën private të personit/viktimës.

4. Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/komisione" llogaritet në ditë pune dhe shoqërohet me sanksion financiar të ndalimit të pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.

5. Vendimi i dhënë për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronjat "a" dhe b" të neni 65/1, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja "c", të nenit 65/1 publikimi bëhet vetëm me pëlqimin e personit/viktimë e ngacmimit seksual.

Neni 65/3

Ankimi ndaj masave të rënda disiplinore

1. Masat e rënda disiplinore, të dhëna sipas neneve 65 dhe 65/1 mund të ankimohen nga deputeti brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit.

2. Ankimi paraqitet me shkrim pranë Byrosë së Kuvendit.

3. Ankimi shoqërohet edhe me materialet ose dokumentet provuese.

4. Me paraqitjen e ankimit, urdhri i drejtuesit të seancës plenare/komisionit dhe/ose vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën pezullohet deri në marrjen e vendimit nga Byroja e Kuvendit.

5. Ndaj vendimit të dhënies së masës disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/ komisione deri në 10 ditë" ushtrohet ankim në Byronë e Kuvendit.

Neni 65/4

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit nga Byroja e Kuvendit

1. Byroja e Kuvendit, brenda 2 ditëve nga marrja e ankimit, shqyrton çështjen duke zhvilluar hetim administrativ që përfshin:

a) marrjen e dokumentacionit të masës së dhënë nga kryetari/drejtuesi i seancës ose Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën;

b) shqyrtimin e dokumenteve provuese të paraqitura nga ankuesi/kërkuesit;

c) kërkimin e provave të tjera, që nuk janë shqyrtuar më parë, ose të ndonjë fakti të ri që ka dalë pas marrjes së vendimit nga drejtuesi i seancës/komisionit ose Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën.

2. Shqyrtimi i çështjes kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton të drejtën e deputetit për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për t'u njohur me provat dhe dokumente të tjera.

3. Të drejtën për të kërkuar marrjen dhe shqyrtimin e provave e ka edhe çdo anëtar i Byrosë.

4. Kur ankuesi është anëtar i Byrosë së Kuvendit, ai përjashtohet nga votimi i çështjes.

5. Nëse anëtari i Byrosë është vendimmarrës ose anëtar i një organi vendimmarrës për masën disiplinore që ankimohet, merr pjesë në shqyrtim pa të drejtë vote.

6. Byroja e Kuvendit merr vendim me shumicë votash në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Në rast barazie votash, ankimi konsiderohet i rrëzuar dhe masa disiplinore lihet në fuqi.

7. Byroja e Kuvendit vendos:

a) rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të masës disiplinore;

b) pranimin e ankimit dhe heqjen e masës disiplinore;

c) pranimin pjesërisht të ankimit dhe ndryshimin e afatit të masës disiplinore të dhënë nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën.

8. Vendimi i Byrosë së Kuvendit është përfundimtar, i formës së prerë dhe ekzekutohet menjëherë.

9. Nëse Byroja e Kuvendit nuk mblidhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vendimi i drejtuesit të seancës plenare/komisionit ose vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën merr formë të prerë.

10. Vendimi i Byrosë së Kuvendit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Në rastin e masës disiplinore për ngacmim seksual publikimi i vendimit bëhet vetëm me pëlqimin e viktimës.".

Neni 48

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 66
Pezullimi dhe mbyllja e seancës plenare

1. Në rast se në sallën e seancës plenare, cenohet seriozisht rendi i punimeve, shkaktohet kaos dhe nuk merren parasysh kërkesat për mbajtjen e rregullit, drejtuesi i seancës plenare lë vendin e tij dhe seanca plenare quhet e pezulluar.

2. Në rast se pas rifillimit të seancës, kaosi vazhdon përsëri, drejtuesi i seancës plenare e pezullon seancën për një periudhë kohe të caktuar ose e mbyll atë.

3. Në rast mbyllje të seancës plenare, Kuvendi mblidhet në seancën plenare më të parë me të njëjtin rend dite.".

Neni 49

Në nenin 68, "Propozimi i projektligjit", bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Projektligji hartohet në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me një relacion, i cili përmban:

a) objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij;

b) argumentet se objektivat nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese;

c) përputhshmërinë e projektligjit me Kushtetutën, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian;

ç) ndikimin ekonomik, social, mjedisor dhe ndjeshmërinë gjinore;

d) shkallën e përmbushjes së objektivave të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, si dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj;

dh) përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma dhe akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Për projektligjet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë efektet financiare të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i tij.".

b) Shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Për projektligjet që duhet të konsultohen me publikun, relacioni përmban:

a) të dhënat për procesin e njoftimit e të konsultimit publik;

b) personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit;

c) shpjegime në lidhje me identifikimin e grupeve të interesit;

ç) pjesëmarrësit në konsultimin publik dhe kohëzgjatjen e procesit të konsultimit;

d) çështjet e diskutuara dhe opinionet e shprehura nga grupet e interesit;

dh) reflektimin ose jo në projektligj të opinioneve të grupeve të interesit.".

c) Shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Komisioni përgjegjës, kur konstaton se projektligji joqeveritar ka faturë financiare, pasi e përfshin atë në kalendarin e punimeve të komisionit të tij, ia përcjell menjëherë Këshillit të Ministrave.".

Neni 50

Në nenin 69, "Shpërndarja e projektligjeve", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së tyre, me përjashtim të rasteve kur në këtë rregullore përcaktohet ndryshe.".

Neni 51

Në nenin 70, "Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera", pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera ose i Këshillit për Legjislacionin hartohen jo më vonë se 4 ditë nga përfundimi i shqyrtimit. Raporti përmban të gjitha ndryshimet e bëra në komision, si dhe propozimet e bëra nga komisionet për dhënie mendimi. Në rast mospranimi të propozimeve ose sugjerimeve të komisioneve të tjera, komisioni përgjegjës paraqet në raport argumentet përkatëse.

Raportet shumëfishohen dhe u shpërndahen deputetëve dhe Këshillit të Ministrave të paktën 1 javë përpara datës së shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare.

Në rastin kur projektligji shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, afati i paraqitjes së raportit është të paktën 2 ditë përpara seancës plenare.".

Neni 52

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 71
Propozimi i amendamenteve në komisionin përgjegjës

1. Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të propozojë amendament/te gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës. Amendamenti paraqitet me shkrim dhe i arsyetuar.

2. Amendamenti i propozuar nga Këshilli i Ministrave shoqërohet nga vlerësimi i përputhshmërisë së tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

3. Komisioni përgjegjës merr në shqyrtim amendamentin e propozuar nga deputeti ose Këshilli i Ministrave dhe jep shpjegime të arsyetuara për miratimin ose rrëzimin e tij në raportin që harton për seancën plenare.".

Neni 53

Në nenin 75, "Shqyrtimi nen për nen", pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

"4. Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t'u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë. Amendamenti i paraqitur nga Këshilli i Ministrave shoqërohet nga vlerësimi i përputhshmërisë së tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe hartohet nga propozuesi i tij.

5. Në rastin kur amendamenti vlerësohet se nuk është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian ose legjislacionin e brendshëm shqiptar, që është përafruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Kryetari i Kuvendit, ose kryetari i një grupi parlamentar, ose një grup prej 7 deputetë, ose kryetari i Komisionit të Integrimit Evropian, kërkon që amendamenti të paraqitet për mendim në komisionin përgjegjës ose në Komisionin për Integrimin Evropian. Zhvillimi i seancës plenare pezullohet në rast se është e nevojshme. Në këtë rast propozuesi i amendamentit dhe përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kanë të drejtë të dëgjohen në mbledhjen e komisionit përgjegjës ose në Komisionin për Integrimin Evropian.".

Neni 54

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 86
Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.

3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës

4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.

5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.

6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.

7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.

8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.".

Neni 55

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 87
Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

1. Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për:

a) vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët;

b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;

c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë;

ç) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi;

d) rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është paraqitur nga jo më pak se 1/5 e deputetëve.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që kanë efekt në legjislacion, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin brenda 30 ditëve pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore, efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli harton një raport dhe ia paraqet atë Kryetarit të Kuvendit.

4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

5. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse.".

Neni 56

Pas nenit 87 shtohet neni 87/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 87/1
Mbarimi/mbyllja e legjislaturës së punimeve të Kuvendit

Me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve të Kuvendit, projektaktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të Kuvendit, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare, i kthehen nismëtarit.".

Neni 57

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 92
Zhvillimi i seancës së pyetjeve

1. Në fillim të çdo seance plenare, të paktën 45 minuta i kushtohen seancës së pyetjeve, me përjashtim të rastit kur në kalendarin e punimeve është përcaktuar ndryshe. Anëtari i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve në fillim të çdo seance plenare. Kryeministri, një herë në javë, është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve për 30 minuta.

2. Pyetjet zgjidhen me short sipas vendimit të Konferencës së Kryetarëve. Procedura e shortit përfshin 7 pyetje dhe zhvillohet në prani të përfaqësuesve të grupeve parlamentare si vijon: dy grupet më të mëdha parlamentare përfaqësohen me nga dy deputetë secili, ndërsa grupet e tjera parlamentare me nga 1 deputet.

3. Kryeministri përgjigjet për pyetjen e bërë për jo më shumë se 6 minuta, ndërsa ministri jo më shumë se 3 minuta. Brenda kësaj kohe përfshihet edhe leximi i pyetjes dhe emri i deputetit që e ka paraqitur.

4. Në rast se tejkalohet koha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, pyetjet, të cilave nuk u janë dhënë përgjigje, zhvillohen në seancën plenare pasardhëse.

5. Pyetjet dhe përgjigjet e tyre publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.".

Neni 58

Në nenin 93, "Përgjigjet e pyetjeve në komision", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Përgjigja e pyetjeve përbën pikën e parë të rendit të ditës të mbledhjes së komisionit të përhershëm pas 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së tyre.".

b) Shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Pyetjet, si dhe përgjigjet e bëra në komision publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.".

Neni 59

Neni 94 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 94
Përgjigjet me shkrim të pyetjeve

1. Në rast se deputeti kërkon përgjigje me shkrim për pyetjen, ai i drejtohet anëtarit përkatës të Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përgjigjet brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Kërkesa e deputetit përcillet brenda 2 ditëve në institucionin përkatës.

2. Në rast se nuk jepet përgjigje brenda kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i Kuvendit, me kërkesë të deputetit, përfshin dhënien e përgjigjes si pikë të parë të rendit të ditës të mbledhjes së komisionit të përhershëm që ka lidhje me objektin e pyetjes.

3. Nëse dhënia e përgjigjes nuk përfshihet si pikë e parë e rendit të ditës së mbledhjes së komisionit, deputeti ka të drejtë të kërkojë zhvillim debati për çështjen ose të kërkojë informacion shtesë. Anëtari i Këshillit të Ministrave/Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dërgon informacionin shtesë brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës.

4. Anëtari i Këshillit të Ministrave mund t'u përgjigjet pyetjeve edhe në periudhën jashtë sesionit parlamentar.

5. Lista e pyetjeve në pritje për përgjigjet publikohet çdo muaj në faqen zyrtare të Kuvendit.".

Neni 60

Në nenin 96, "Interpelancat", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Interpelanca kërkohet nga çdo deputet, grup deputetësh ose grup parlamentar.".

Neni 61

Në nenin 97, "Interpelancat për çështje urgjente", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Një kryetar grupi parlamentar ose 7 deputetë mund të kërkojnë zhvillim interpelance për çështje urgjente. Çdo kryetar grupi parlamentar mund të kërkojë jo më shumë se dy interpelanca për çështje urgjente gjatë një muaji dhe çdo deputet mund të nënshkruajë jo më shumë se dy interpelanca të tilla gjatë një muaji.".

Neni 62

Në nenin 102, "Kontrolli nga komisionet e përhershme të Kuvendit", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Komisionet kanë të drejtë të thërrasin ministrat në çdo kohë për të dhënë shpjegime dhe sqarime për çështje të fushave të përgjegjësisë së tyre, ose për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave dhe deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre, si dhe për çështje që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura të adresuara kundrejt tyre.".

Neni 63

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 103
Raportimi në Kuvend

1. Konferenca e Kryetarëve, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, vendos në fillim të çdo viti për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

2. Kalendari përmban organin kushtetues dhe atë të krijuar me ligj që do të raportojë, komisionin përgjegjës për shqyrtim, afatin ligjor për depozitimin e raportit në Kuvend. Kuvendi u kërkon zyrtarisht institucioneve të mësipërme dorëzimin e raportit në Kuvend brenda afatit ligjor. Kalendari i paraqitjes së raporteve njoftohet në seancën plenare më të parë, publikohet dhe iu shpërndahet institucioneve.

3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit. Komisioni përgjegjës organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare.

4. Komisioni, kur e çmon të nevojshme, në varësi të çështjeve të trajtuara në raportin vjetor ose

që dalin gjatë shqyrtimit të tij, mund t'u kërkojë informacione me shkrim institucioneve të tjera shtetërore ose institucioneve të pavarura, si dhe/ose mendimin me shkrim organizatave të shoqërisë civile, që bashkëveprojnë dhe kontribuojnë në fushat që mbulon institucioni i pavarur.

5. Komisioni në vlerësimin e raportit thërret në seancë dëgjimore titullarin e institucionit shtetëror ose të varësisë së tij për të dhënë informacion /shpjegime lidhur me çështjen e referuar nga institucioni i pavarur.

6. Në rezolutë, komisioni mund të reflektojë rekomandime bazuar edhe në faktet e mbledhura nga organet e përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Në seancë plenare, titullari i institucionit paraqet raportin për jo më shumë se 20 minuta. Në vijim lexohet projektrezoluta e komisionit përkatës për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vazhdohet me pyetjet dhe përgjigjet e tyre.

8. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë me shkrim zhvillimin e debatit. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve në përputhje me nenin 48, pika 3, të kësaj rregulloreje. Në përfundim të debatit votohet projektrezoluta e paraqitur nga komisioni, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 99 të kësaj rregulloreje.

9. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë të thirren në seancë plenare drejtuesit e institucioneve shtetërore për të dhënë shpjegime ose për të informuar Kuvendin për çështje të veprimtarisë së tyre. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe Kuvendi vendos me votim të hapur dhe pa debat pasi dëgjon një folës pro dhe një kundër, jo më shumë se 3 minuta.

10. Raportimi në Kuvend i institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj duhet të përfundojë jo më vonë se muaji qershor.

11. Kuvendi miraton Mekanizmin e Monitorimit Periodik dhe Vjetor të institucioneve, si dhe udhëzimin e zbatimit të këtij mekanizmi.".

Neni 64

Pas nenit 103 shtohet kreu IV me këtë përmbajtje:

"KREU IV
KONTROLLI PARLAMENTAR PËR PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE"

Në këtë krye shtohen nenet 103/1, 103/2, 103/3 dhe 103/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 103/1
Raportimi në Kuvend për procesin e integrimit evropian

1. Kuvendi monitoron punën e Këshillit të Ministrave në lidhje me zbatimin e detyrimeve për procesin e integrimit evropian dhe të institucioneve të pavarura kushtetuese e të krijuara me ligj, sipas parashikimeve të neneve 18–20 të legjislacionit në fuqi për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2. Çdo fillim viti Kuvendi shqyrton raportin e detajuar të Këshillit të Ministrave për procesin e integrimit, sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

3. Pas depozitimit të raportit, Kryetari i Kuvendit ia dërgon menjëherë komisionit përgjegjës për shqyrtim. Komisioni organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim harton projektrezolutën që ia paraqet seancës plenare.

4. Kuvendi organizon një seancë me debat dhe në fund të saj miraton rezolutën përkatëse.

5. Kuvendi, jo më vonë se dy javë pas depozitimit të raportit të Këshillit të Ministrave për gjetjet dhe rekomandimet e raportit të progresit të Komisionit Evropian, organizon një seancë plenare, në përfundim të së cilës miratohet rezoluta përkatëse.

6. Komisioni i Integrimit Evropian dhe komisionet e tjera, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërrasin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione për çështje të integrimit evropian.

7. Komisionet parlamentare, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, hartojnë një kalendar të veçantë me seancat dëgjimore të institucioneve të pavarura, në drejtim të monitorimit të procesit të integrimit në BE.

8. Komisionet mund t'u kërkojnë institucioneve të pavarura planet vjetore të veprimit, që hartohen

sipas rekomandimeve të raportit të progresit të BE-së, të cilat shqyrtohen në seanca të veçanta. Në fund të diskutimeve, komisionet hartojnë raporte duke marrë gjithashtu parasysh zbatimin e rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është një shtet anëtar. Institucioneve të pavarura u jepet informacion nëse komisionet kanë marrë parasysh kontributin e tyre ose jo.

Neni 103/2

Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian

1. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian kryen funksionin e monitorimit të procesit të integrimit evropian, si dhe çdo detyrë tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe rregulloren e tij të brendshme.

2. Komisionet e përhershme të Kuvendit mund të kërkojnë në çdo kohë seancë dëgjimore me anëtarët e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian, si dhe të kërkojnë dokumente ose çdo informacion tjetër që ata e vlerësojnë të nevojshëm në kuadër të monitorimit për çështjet e lidhura me integrimin në Bashkimin Evropian.

3. Gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit, Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian është pika kryesore e dialogut civil dhe social, i cili jep opinione të specializuara, bazuar në konsensusin sa më të gjerë për këtë proces.

4. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian mbështetet nga Sekretariati Teknik dhe mund të kërkojë mbështetje teknike edhe nga Shërbimet e Kuvendit.

Neni 103/3

Shqyrtimi *ex-post* i legjislacionit të përafruar me legjislacionin e BE-së

1. Komisioni për Integrimin Evropian përzgjedh për të shqyrtuar pjesë të legjislacionit që kanë përafruar legjislacionin e BE-së, të paktën pas 3 vjetëve të zbatimit të tyre.

2. Komisioni harton planin vjetor për shqyrtimin e tyre *ex-post* në fillim të çdo viti dhe informon Kryetarin e Kuvendit dhe kryetarët e komisioneve të tjera të përhershme. Plani mund të plotësohet ose të përmirësohet bazuar në propozimet e përbashkëta të Komisionit për Integrimin Evropian dhe komisioneve të përhershme. Në rast mosmarrëveshjeje, çështja shqyrtohet në Konferencën e Kryetarëve.

3. Pas miratimit të planit nga Konferenca e Kryetarëve, Komisioni për Integrim Evropian ia përcjell planin vjetor, me afatet kohore të përcaktuara, ministrit përgjegjës për Marrëdhëniet me Kuvendin dhe ministrive përgjegjëse.

4. Ministritë përgjegjës përgatisin dhe dërgojnë në Kuvend, në komisionet e përhershme, raportin për zbatimin e legjislacionit që duhet shqyrtuar, sipas kërkesës së Komisionit për Integrim Evropian. Raporti duhet të përmbajë: një vlerësim paraprak të kornizës ligjore që do të shqyrtohet; një analizë për shkallën e zbatueshmërisë së legjislacionit të përafruar; një përshkrim të shkurtër të legjislacionit përkatës të deleguar dhe çdo dokument tjetër vlerësimi që ministria përgjegjëse mban për këtë qëllim.

5. Komisioni për Integrim Evropian verifikon nëse të gjitha memorandumet e kërkuara për shqyrtimin *ex-post* të legjislacionit të përafruar janë dorëzuar në kohë në komisionet e përhershme.

6. Komisionet e përhershme, pas marrjes së raportit lidhur me zbatimin e legjislacionit të përafruar, hartojnë raportin e tyre për shqyrtimin e legjislacionit *ex-post*. Komisionet mund të bëjnë konsultime publike, seanca dëgjimore me grupet e interesuara dhe të përdorin çdo material tjetër, si: vlerësimi për ndikimin e legjislacionit; vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; vendime të gjykatave kombëtare; opinione, deklarata/qëndrime, raporte të institucioneve të BE-së; raporte kombëtare nga shtetet anëtare për zbatimin praktik të kornizave të BE-së, ose literaturë akademike.

7. Raporti i shqyrtimit *ex-post*, i hartuar sipas përcaktimeve të paragrafit 6 të këtij neni, i dorëzohet Komisionit për Integrimin Evropian brenda afatit të miratuar nga Komisioni për Integrimin Evropian dhe komisioni i përhershëm përkatës. Në rast mosmarrëveshjeje, Kryetari vendos afatet brenda të cilave komisioni i përhershëm do të përgatisë raportin e tij.

8. Komisioni për Integrimin Evropian dhe komisioni i përhershëm diskutojnë për raportin e vlerësimit *ex-post* në një mbledhje të përbashkët dhe e dorëzojnë atë në seancë plenare.

9. Të gjitha raportet e vlerësimit *ex-post* publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.

Neni 103/4
Plani i veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të BE

1. Konferenca e Kryetarëve, çdo vit, miraton planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian.

2. Plani vjetor i veprimit për integrimin evropian pasqyron gjetjet, rekomandimet dhe sfidat e identifikuara në raportin e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për kriterin politik/Kuvendin, si dhe masat konkrete që duhet të merren për realizimin e objektivave të Kuvendit.

3. Plani i veprimit u bëhet i njohur anëtarëve të Kuvendit dhe u vihet në dispozicion grupeve parlamentare.".

Neni 65

Në nenin 104, "Peticionet", shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Komisioni përgjegjës mund të vendosë dërgimin e peticionit një komisioni tjetër parlamentar, Këshillit të Ministrave, institucioneve publike dhe Avokatit të Popullit për veprime të mëtejshme, me qëllim marrjen e informacioneve. Në përfundim, komisioni jep shpjegime me shkrim, propozon nismë legjislative ose merr vendim.".

Neni 66

Në nenin 107, "Botimet parlamentare", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Botimet parlamentare përfshijnë:

a) procesverbalet e seancave plenare të Kuvendit;

b) procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve të Kuvendit dhe të seancave plenare, përkatësisht sipas neneve 39 dhe 54 të kësaj rregulloreje;

c) ligjet, vendimet, rezolutat dhe deklaratat e miratuara nga Kuvendi;

ç) paraqitjen e veprimtarisë së Kuvendit dhe të organeve të tij;

d) raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit;

dh) raportin vjetor për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit;

e) publikimet e paraqitura në faqen zyrtare të Kuvendit.".

Neni 67

Neni 111 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 111
Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj

1. Kandidaturat për në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe të përmbajnë një jetëshkrim të përditësuar të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin.

2. Për paraqitjen e kandidaturave zhvillohet procedura paraprake e përzgjedhjes si më poshtë:

a) Kuvendi bën shpalljen dhe publikimin e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik, për një afat prej 20 ditësh nga publikimi;

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit;

c) Brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të listës së kandidaturave të vetofruara te grupet parlamentare, organizohet dëgjesa e hapur publike në mjediset e Kuvendit, ku njoftohen të marrin pjesë të gjithë deputetët/grupet parlamentare;

ç) Pas dëgjesës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit;

d) Kandidaturat, që marrin mbështetjen me firma të jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në këtë nen.

3. Kandidaturat duhet të propozohen 45 deri në 30 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues apo të krijuar me ligj.

4. Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përkatës, i cili vendos nëse kandidaturat i

plotësojnë kushtet ligjore brenda tre javëve nga marrja e kërkesës.

5. Në rastet kur zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj bëhet nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, procedohet sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Në të gjitha rastet, komisioni përkatës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Komisioni organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat. Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon zyrtarisht institucionit propozues për plotësimin e tij. Në rastin kur kandidatura nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues. Procedura e shqyrtimit në Kuvend vazhdon me paraqitjen e kandidaturës së re nga institucioni propozues.

7. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës dhe jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit ose nga data e shkarkimit.

8. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.".

Neni 68

Në nenin 114, "Shkarkimi i anëtarëve të organeve kushtetuese", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Kuvendi shqyrton raportin e komisionit hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim të anëtarit të organit kushtetues, si dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj rregulloreje.

Në rast se anëtari i organit kushtetues, për të cilin është paraqitur kërkesa për shkarkim, kërkon të dëgjohet në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë.

Kuvendi vendos për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë.

Për ato raste që parashikohen në Kushtetutë, vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues i dërgohet brenda 5 ditëve Gjykatës Kushtetuese.".

Neni 69

Neni 118 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 118

Dhënia e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës

1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës i paraqitet Kryetarit të Kuvendit nga prokurori. Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin.

2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes, të përfaqësohet me mbrojtës ligjor, të drejtojë pyetje dhe të kërkojë sqarime në lidhje me kërkesën me qëllim të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes.

3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda 2 javëve harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve.

4. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo të kontrollit personal ose të banesës të një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në seancë

plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të hapur për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës ndaj deputetit.

5. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të një deputeti brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi.

6. Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të anëtarit të Këshillit të Ministrave.".

Neni 70

Neni 119 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 119
Procedura në rastin kur deputeti është ndaluar ose arrestuar

1. Në rastin kur një deputet është ndaluar ose arrestuar pa autorizim në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vë menjëherë në dijeni Kryetarin e Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit thërret menjëherë Këshillin për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet, i paraqet dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe i kërkon të shqyrtojë çështjen.

3. Këshilli, jo më vonë se 48 orë nga data e vënies në dijeni, kryen procedurat sipas parashikimeve të nenit 73, paragrafët 3 dhe 4, të Kushtetutës dhe zbaton parashikimet e paragrafit 2 të nenit 118 të kësaj rregullore lidhur me të drejtën për një proces të rregullt.

4. Këshilli paraqet raportin për seancën plenare të Kuvendit, e cila thirret nga Kryetari i Kuvendit brenda 48 orëve nga paraqitja e raportit. Vendimi i Kuvendit merret sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 73 të Kushtetutës.".

Neni 71

Pas nenit 119 shtohet neni 119/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 119/1
Procedura e konstatimit të kufizimeve

1. Kufizimet e përcaktuara në këtë nen fillojnë ditën që deputeti shpallet i zgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose, në rast ankimi, nga gjykata kompetente. Deputeti merr të gjitha masat për të shmangur çdo situatë papajtueshmërie ose konflikti interesi, që mund të lindë në momentin e fillimit të mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës që ai vazhdon. Deputeti ndërmerr veprimet konkrete jo më vonë se momenti i shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe qartësia te deputeti për të ardhurat e tij financiare.

2. Për çdo shkelje të kufizimeve të këtij neni, çështja dërgohet pa vonesë në Gjykatën Kushtetuese. Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, verifikon nëse mocioni i paraqitur plotëson kërkesat juridiko-formale, siç janë numri i anëtarëve nënshkrues, ekzistenca e dokumentacionit dhe provave që mbështesin mocionin e paraqitur, verifikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, verifikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e rregullores së tij.

3. Kuvendi nuk vë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk ia nënshtron atë debatit parlamentar, pasi nuk i hyn themelit të çështjes për të vlerësuar nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij.

4. Vlerësimi i meritës së çështjes, nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur pikën 3, të nenit

70, të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.".

Neni 72

Në nenin 120, "Shërbimet e Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese organizative, koordinuese dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Shërbimet e Kuvendit krijojnë mundësi dhe kushte të barabarta që deputetët, Kuvendi dhe organet e tij të ushtrojnë funksionet kushtetuese dhe ligjore.".

b) Pika 2 shfuqizohet

Neni 73

Në nenin 121, "Drejtimi i shërbimeve të Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Shërbimet e Kuvendit drejtohen dhe përgjigjen para Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili është nëpunësi më i lartë civil në Kuvend, që emërohet në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.".

b) Pika 3 shfuqizohet.

c) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Përbërja e shërbimeve të Kuvendit, struktura e detajuar dhe kufiri organik i punonjësve vendoset nga Byroja e Kuvendit, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm.".

Neni 74

Pas nenit 121 shtohet neni 121/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 121/1
Llogaritja e afateve

1. Kur afati i parashikuar në këtë rregullore caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

2. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës kur ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Nuk llogariten periudhat jashtë sesionit parlamentar, me përjashtim të rastit kur çështja përfshihet në rendin e ditës të sesionit të jashtëzakonshëm.".

Neni 75

Neni 122 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 122
Shërbimi i Sigurisë në Kuvend

1. Për të siguruar rendin dhe qetësinë, në të gjitha mjediset e Kuvendit funksionon Shërbimi i Sigurisë në Kuvend. Shërbimi i Sigurisë në mjediset e Kuvendit është i armatosur, ndërsa në sallën e zhvillimit të seancave plenare ose mbledhjeve të organeve të Kuvendit është i paarmatosur.

2. Shërbimi i Sigurisë pajiset me uniformë të veçantë dhe mjete teknike për plotësimin e detyrave të tij.

3. Punonjësit e Shërbimit të Sigurisë në Kuvend në sallën e zhvillimit të seancave plenare dhe mbledhjeve të organeve të Kuvendit veprojnë vetëm me urdhër të Kryetarit ose të drejtuesit të seancës/mbledhjes, ndërsa jashtë tyre sipas rregullave të përcaktuara nga Byroja e Kuvendit.

4. Shërbimi i Sigurisë në Kuvend siguron kontrollin e hyrje - daljeve të të gjithë personave në mjediset e Kuvendit. Kur dyshohet se personi mban armë, lëndë plasëse, sende të dëmshme ose materiale të papërshtatshme, të cilat mund të pengojnë zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, ai kontrollohet edhe fizikisht. Në rastet kur personi nuk pranon të kontrollohet, Shërbimi i Sigurisë ndalon hyrjen e tij në mjediset e Kuvendit dhe vepron sipas legjislacionit në fuqi. Përjashtohen nga kontrolli Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, ambasadorët e akreditуar

në Republikën e Shqipërisë apo me status të barabartë me ta.

5. Shërbimi i Sigurisë në Kuvend për anën administrative, financiare dhe të përgatitjes profesionale bën pjesë në Gardën e Republikës.".

Neni 76

Aneksi 1, "Për kufizimin e imunitetit të deputetit dhe kushtet për autorizimin e ndjekjes penale", shfuqizohet.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.7.2019.

VENDIM
Nr. 86/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Deputeti Nikolin Staka largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Integrimin Europian.

2. Deputetja Suzana Topi largohet nga Komisioni për Integrimin Europian dhe caktohet anëtare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

3. Deputeti Ramazan Gjuzi caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.7.2019.

DEKRET
Nr. 11233, datë 22.7.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lutvina Agron Pfeffler (Dibra)
2. Hergys Vladimir Agaraj
3. Julia Besim Agaraj (Kurti)
4. Christian Hergys Agaraj
5. Gjergj Janaq Makoçi
6. Katerina Spiro Makoçi (Fotiadhi)
7. Stefania Gjergj Makoçi
8. Kasjani Gjergj Makoçi
9. Anna Aleks Lajthia
10. Anila Shaban Smajli (Ulliri)
11. Ortanca Eduart Noack (Koka)
12. Aurel Hysen Saraçi
13. Myrvete Vezir Gross (Groβ/Hebeja)
14. Artan Abedin Taci
15. Leslia Ylli Fikaj
16. Klevisa Iljaz Kullolli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 499, datë 2.7.2019

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE EMËRIMIT TË MJEKËVE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NËPËRMJET PLATFORMËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe të nenit 199 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale",

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin e mjekëve në institucionet shëndetësore publike, nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë".

2. Procedurat për punësimin e mjekëve udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.

3. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë".

4. Drejtoria Qendrore e Operatori të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim "DQOSHKSH") është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mjekëve në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, ndërsa drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim "DROSHKSH") dhe drejtoritë e spitaleve universitare (në vazhdim "DSU") respektivisht, organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

5. DROSHKSH-ja dhe DSU-ja kanë detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurrimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.

6. DQOSHKSH ka detyrimin të shpallë në portalin "Mjekë për Shqipërinë" përgjatë gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion shëndetësor publik sipas kërkesës së tyre, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji.

7. Për të marrë pjesë në Programin e Bonusit mjeku specialist aplikon përmes platformës elektronike "Mjekë për Shqipërinë".

8. Procesi i konkurrimit zhvillohet për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për ushtrimin e profesionit të mjekut, si dhe kriteret specifike të pozicionit të punës.

9. Kandidatët e interesuar për t'u punësuar si mjekë në institucionet shëndetësore publike marrin pjesë në konkurrim, i cili zhvillohet në dy faza:

a) konkurrimi me dosje;

b) intervista.

KREU II
SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI

1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së raportojnë vendet e lira të punës që krijohen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së.

a) Drejtoritë rajonale të OSHKSH-së analizojnë nevojën për pozicionin e punës (mjek) të mbetur vakant, nëse vlerësohet se për këtë pozicion nuk plotësohet ngarkesa e punës dhe është i panevojshëm për institucionin, deklarohet në Ministri si pozicion tepër. Për pozicionet mjekë, të mbetura vakante, për të cilat do të hapen procedurat e konkurrimit, DROSHKSH-të përgatisin listën sipas institucioneve shëndetësore publike dhe i dërgojnë pranë DQOSHKSH-së, e cila përgatit shpalljen dhe i publikon në portalin "Mjekë për Shqipërinë".

b) Qendrat spitalore universitare identifikojnë vendet vakant për mjekë sipas shërbimeve dhe përgatisin shpalljen. qendrat spitalore universitare dërgojnë shpalljen e vendeve të lira pranë DQOSHKSH-së e cila ka përgjegjësinë për ti publikuar në portalin "Mjekë për Shqipërinë".

2. Shpallja e vendeve vakant për mjekë familje/mjekë të përgjithshëm bëhet e grupuar mbi bazë të njësisë vendore të kujdesit shëndetësor (në vijim "NJVKSH"). Shpallja e vendeve vakant mjekë specialistë në spitale/poliklinika dhe qendra shëndetësore bëhet për pozicion sipas specialitetit përkatës.

3. Shpallja në portalin "Mjekë për Shqipërinë" përmban këto të dhëna:

a) kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranim;

b) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet intervista;

c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

d) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

e) datën e shpalljes së verifikimit paraprak të kandidatëve;

f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe intervistën;

g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

4. Kandidatët e interesuar, regjistrohen në portalin "Mjekë për Shqipërinë" dhe ngarkojnë në portal dokumentet e kërkuar. Një kopje e dokumenteve dërgohet pranë DROSHKSH-së apo spitaleve universitare me postë ose dorazi me protokoll. Afati i aplikimit është jo më pak se dy javë kalendarike nga data e shpalljes së vendit vakant.

5. Dosja e aplikimit përmban:

a) jetëshkrimin e kandidatit (CV), (i detyrueshëm);

b) librezën e punës;

c) diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (e detyrueshme);

d) diplomën e specializimit dhe listës së notave (e detyrueshme nëse pozicioni i punës është për mjek specialist);

e) lejen e ushtrimit të profesionit (e detyrueshme);

f) dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor);

g) dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja;

h) certifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit;

i) deklaratë për gjendjen gjyqësore (e detyrueshme) sipas shtojcës 3;

j) raporti mjekoligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës).

6. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet. Kandidatët të cilët janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik nuk mund të konkurrojnë nëpërmjet kësaj platforme, për ata do të zbatohen procedurat e lëvizjes paralele brenda NJVKSH-së.

KREU III
VLERËSIMI DHE EMËRIMI

1. Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në shëndetësi, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për intervistën me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë, përkatësisht:

a) deri në 45 pikë vlerësimi i dosjes;

b) deri në 5 pikë vlerësimi i intervistës me gojë.

Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Komisioni i Vlerësimit, brenda pesë ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe brenda dy ditëve shpall emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit dhe ia dërgon DQOSHKSH-së për t'i publikuar në portalin "Mjekë për Shqipërinë".

3. Komisioni i Vlerësimit në të njëjtën ditë, që publikohet lista me emrat e kandidatëve, i njofton ata nëpërmjet adresës së *e-mail*-it, të cilën e ka dhënë kandidati për komunikim, për pikët që ka marrë nga vlerësimi i dosjes, si dhe për datën dhe vendin e intervistës. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit njofton me *e-mail* dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyet e moskualifikimit.

4. Kandidatët kanë të drejtë ankimimi brenda dy ditëve nga njoftimi i tyre. Ankesa bëhet nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë".

5. Komisioni i Vlerësimit ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe brenda dy ditëve i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet adresës së tyre me *e-mail*.

6. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar, brenda dy ditëve nga dita e njoftimit të tyre. Ankesa bëhet përmes portalit "Mjekë për Shqipërinë".

7. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimuesit me shkrim ose sipas formës që do të dakordësohet.

8. Pas përfundimit të afateve të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Vlerësimit shpall renditjen e kandidatëve dhe e dërgon pranë DQOSHKSH-së, e cila menjëherë bën publikimin në portalin "Mjekë për Shqipërinë".

9. Kandidati mjek familje/mjek i përgjithshëm i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-ve, është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet shëndetësore të NJVKSH-së përkatëse dhe është i detyruar të konfirmojë në DROSHKSH brenda 24 orëve, nga njoftimi për përzgjedhje, në adresën elektronike. Në rast se DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Kandidati që nuk konfirmon pranimin e pozicionit të punës ose e refuzon atë, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë deri në shpalljen e radhës për konkurrim.

10. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, merr aktin e emërimit nga DROSHKSH-ja dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën e punës. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me mjekun që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

11. Kandidati mjek specialist që ka konkurruar për një spital/poliklinike/QSH i cili në renditjen e përgjithshme për këtë institucion, është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës në atë institucion dhe është i detyruar të konfirmojë në spitalin universitar/DROSHKSH përkatës brenda 24 orëve, nga njoftimi për përzgjedhje, në adresën elektronike. Në rast se spitali universitar/DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Drejtoritë e spitaleve universitare bazuar në statutet e tyre, mund të vendosin një kufi minimal pikësh për tu konsideruar kandidat fitues.

12. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar nëse ka të tillë, nëse nuk ka PAK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka mesataren më të larta në listën e notave të diplomës universitare.

13. DROSHKSH-ja/spitali universitar dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raporton me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në DQOSHKSH, si dhe në MSHMS, brenda datës pesë të çdo muaji për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

14. Përkatësisht, Drejtoria Rajonale e OSHKSH-së të rajonit përkatës ose qendrat spitalore universitare nxjerrin aktin e emërimit për fituesin. Kandidati i shpallur fitues lidh kontratë individuale pune me institucionin shëndetësor.

15. Kandidatët mjekë familje/mjekë të përgjithshëm, për të cilët nuk ka një vend vakant, qëndrojnë në listën e pritjes për një vend pune në NJVKSH ku është kualifikuar, deri në shpalljen e radhës.

16. DROSHKSH-ja dhe DSP-ja dërgojnë listën me emrat e fituesve pranë DQOSHKSH-së e cila ka detyrimin ti publikojë menjëherë në portalin "Mjekë për Shqipërinë".

KREU IV
KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë:

a) DQOSHKSH-ja krijon komisionet për vlerësimin e kandidatëve për mjekë në spitalet rajonale e bashkiake/NJVKSH dhe në qendrat shëndetësore, me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtori i DROSHKSH-së	kryetar;
2. Një përfaqësues nga DQOSHKSH-ja	anëtar;
3. Një përfaqësues nga shërbimi spitalor ose NJVKSH-ja	anëtar.

b) Spitalet universitare krijojnë komisionet për vlerësimin e kandidatëve për mjekë në institucionet respektive, me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtori ose nëndrejtori	kryetar;
2. Një përfaqësues nga shërbimi mjekësor përkatës	anëtar;
3. Një përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore	anëtar.

c) Në rastet kur një kandidat aplikon njëkohësisht në më shumë se një pozicion pune, që duhet të vlerësohet nga më shumë se një komision, DQOSHKSH-ja krijon komision *ad hoc* për vlerësimin e dosjes së kandidatëve me përfaqësues të komisioneve, sipas pikave "a" dhe "b".

2. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DROSHKSH dhe DSU, kryen rolin e sekretarit teknik për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

3. Anëtarët e komisionit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët (shtojca 2).

4. Komisioni kryen detyrat si më poshtë:

a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin "Mjekë për Shqipërinë";

b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;

c) bën intervistimin e kandidatëve;

d) bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;

e) shqyrton ankesat e kandidatëve;

f) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;

g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat.

f) dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurrimit pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së apo drejtorisë së spitalit universitar përkatës.

KREU V
PLOTËSIMI I VENDEVE VAKANTE NËPËRMJET PROGRAMIT TË BONUSIT

1. MSHMS-ja shpall vendet vakant për mjekë specialistë në spitalet rajonale/bashkiake për të cilat do të aplikohet Programi i Bonusit.

2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike.

3. Për aplikim nevojitet:

a) kërkesa për shprehje interesi;

b) vërtetimi i punësimit nga institucioni shëndetësor ku punon, si dhe leje nga institucioni për pjesëmarrje në Programin e Bonusit;

c) diploma e specialitetit.

4. MSHMS-ja krijon Komisionin e Vlerësimit për aplikantët në Programin e Bonusit. Komisioni i vlerësimit administron dokumentet e aplikantëve, zhvillon intervistën me kandidatët dhe zgjedh fituesin mbi bazën e përcaktimeve të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Mjeku specialist që fiton nga Programi i Bonusit lidh kontratë me MSHMS-në, me institucionin shëndetësor ku do të punojë dhe me Drejtorinë Rajonale të FSDKSH-së.

6. Në përfundim të kontratës mjeku specialist kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

KREU VI
PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE DHE TRANSFERIMI

1. Procedura e lëvizjes paralele për mjekë të përgjithshëm /mjekë familje, bëhet për plotësimin e vendeve të lira vetëm brenda NJVKSH-së përkatëse.

2. Mjekët e emëruar nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë" u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.

3. Mjeku bën kërkesë për lëvizje paralele nga një qendër shëndetësore në një tjetër qendër shëndetësore pranë NJVKSH-së përkatëse. NJVKSH-ja merr masa për mbulimin e shërbimit në qendrën nga e cila kërkon të largohet mjeku dhe e dërgon kërkesën për miratimin e lëvizjes pranë DROSHKSH-së.

4. Lëvizjet paralele raportohen nga DROSHKSH-ja, brenda datës pesë të çdo muaji, pranë DQOSHKSH-së dhe Ministrisë.

5. Transferimi i mjekëve jashtë NJVKSH-së ku është i punësuar, bëhet me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

KREU VII
MASA DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA I MJEKËVE

1. Procedura disiplinore ndaj mjekut fillon nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar.

2. Shkeljet disiplinore, si rregull përcaktohen në kontratën individuale të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

4. Mjeku mund të pezullohet nga puna për shkaqe të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjatë kohës së pezullimit, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet financiare.

5. Largimi nga puna i mjekut bëhet nga drejtori/titullari i institucionit sipas akteve ligjore në

fuqi dhe njoftohet NJVKSH-ja/DROSHKSH-ja dhe DQOSHKSH-ja.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra në zbatimin e këtij udhëzimi ruhen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së ose institucionit qendror shëndetësor dhe janë objekt verifikimi nga MSHMS-ja.

2. Udhëzimi nr. 402, datë 14.5.2019 "Për procedurat e punësimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike", urdhri i ministrit nr. 355, datë 18.8.2014 "Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare", urdhri nr. 511, datë 13.12.2011 "Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor Publik", shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MSHMS-ja, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-së, si dhe institucionet shëndetësore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA 1
KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR MJEKË TË PËRGJITHSHËM DHE MJEKË SPECIALISTË

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1.	Përvoja në punë si mjek (një pikë për çdo vit pune, deri në 15 vite eksperiencë pune).	1-15 pikë
2 .	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 5.50 = 1 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 5.51 - 6.00 = 2 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 6.50 = 3 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 6.51 - 7.00 = 4 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 7.50 = 5 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 7.51 - 8.00 = 6 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 8.50 = 7 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 8.51 - 9.00 = 8 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 9.50 = 9 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 9.51 - 10.00 = 10 pikë.	5 -10 pikë
3.	Nota mesatare e studimeve të specialitetit, vlerësimi bëhet sipas pikës 2.	5-10 pikë
4.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet të huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1 = 2 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B2 = 4 pikë; Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 5 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do të llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0 - 4 pikë

5.	Grada shkencore - maksimumi 4 pikë: Studime doktorature në shëndetësi - 4 pikë; Studime master në menaxhim shëndetësor - 2 pikë.	0- 4 pikë
6.	Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën - maksimumi 2 pikë: a. kualifikime nga 3 deri në 6 muaj - 1 pikë; b. kualifikime 6 muaj e më shumë - 2 pikë.	0-2 pikë

SHTOJCA 2

DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaroj në përgjegjësinë time, se në procesin e konkurrimit për pozicionin mjek pranë _____ që do të zhvillohet në datë _____, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI
DATA

SHTOJCA 3

DEKLARIM I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:
Emër, atësi, mbiemër:
Datëlindja:
Vendlindja:
Dokumenti i identifikimit: (kopje bashkëlidhur formularit)
Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: i/e padënuar i/e dënuar
Emër, mbiemër: Firmë:

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.
Shënim. Trajtimi i të dhënave personale, në vijim të përdorimit të këtij autorizimi, do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

UDHËZIM
Nr. 7, datë 22.7.2019

PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TE ORGANIZATAT E PESHKIMIT, NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE SUBJEKTET PRIVATE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, shkronja "d", të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 22.5.2019 "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private",

UDHËZOJ:

1. Procedura për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private, zhvillohen nga ministria përgjegjëse për peshkimin, në bazë të vendimit nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private".

2. Ministria i kërkon Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës përgatitjen e dokumentacionit për dhënien me qira, enfiteozë ose në menaxhim të infrastrukturës së peshkimit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, përveç pikës "b", e cila përgatitet nga drejtoria përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit.

3. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira/enfiteozë të infrastrukturës së lidhur me peshkimin (shkallët e riparimit), janë:

a) Niveli i investimit:

Investim në kuptim të këtij kriteri do të konsiderohet vlera monetare e parashikuar në plan biznes për realizimin e projektit.

b) Niveli i punësimit:

Do të konsiderohet numri total i të punësuarve gjatë periudhës së zbatimit të kontratës së qirasë ose enfiteozës. Për efekt konkurrimi do të merret për bazë numri minimal i deklaruar nga subjekti ofertues, për çdo vit kalendarik.

c) Oferta e detyrimit mujor të qirasë:

Do të konsiderohet pagesa mujore që do të kryhet nga qiramarrësi ose enfiteozmarrësi në përmbushje të detyrimeve kontraktore.

4. Në rastet kur infrastruktura e lidhur me peshkimin (shkallët e riparimit) jepet me qira ose me enfiteozë dhe ka më shumë se një ofertë të vlefshme, për vlerësimin e ofertuesit fitues, vlerësimi do të bëhet në zbatim të metodologjisë së vlerësimit, si më poshtë vijon:

- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kritereve dhe metodologjisë së vlerësimit dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues, që ka numër më të lartë të pikëve, në bazë të kritereve të vlerësimit.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar në zbatim të urdhrit të ministrit, sipas pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019, do të vlerësojë ofertat, duke u bazuar:

a) në kriteret e përcaktuara në pikën 9, të kreut I të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019;

b) pikët e shpallura në konkurrim (pikët do të variojnë dhe përcaktohen në bazë të rëndësisë që do t'i akordohet një kriteri të caktuar në urdhrin e ministrit në varësi të procedurës konkurruese rast pas rasti), duke vlerësuar ofertën më të favorshme me pikët maksimale të kriterit.

- Ofertuesi tjetër do të përfitojë pikët, duke u bazuar në aplikimin e formulës së mëposhtme:

$$Pof = \frac{Oof}{O\ max} \times Pk$$

Pas përcaktimit të pikëve të vlerësimit për secilin kriter bëhet përllogaritja totale e pikëve si më poshtë:

Pt = P1+P2 + P3

Ku:

Pof- pikët që përfiton ofertuesi

Oof- oferta e ofertuesit

Omax - oferta që ka fituar pikët maksimale

Pk- pikët për kriter që do të përcaktohen në urdhër të ministrit rast pas rasti

Pt- pikët totale

P1, P2- Pikët për kriterin e parë, të dytë e në vijim.

5. Në rastet kur infrastruktura e peshkimit (porti dhe markata) do të transferohet për menaxhim pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ose te organizatat e peshkimit, me urdhër ministri ngrihet, një komision i cili do të shqyrtojë kërkesat e paraqitura, ku në përbërje të tij të jenë edhe anëtarë të drejtorisë përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit.

6. Kriteret për vlerësimin e planit të menaxhimit të paraqitur nga OMP-ja ose njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a) Investimet e parashikuara

Vlera monetare e nevojshme për kryerjen e investimeve në port ose markatë gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes.

b) Plani për sigurinë e infrastrukturës

Masat e nevojshme me qëllim krijimin e një gjendje të sigurt për subjektet që ushtrojnë veprimtari në port dhe/ose në markatë.

c) Cilësia e shërbimit

Tërësia e masave të nevojshme me qëllim ofrimin e shërbimit bazë, në një periudhë të shkurtër kohore dhe me cilësi të lartë.

ç) Kostot operative

Tërësia e shpenzimeve të nevojshme, gjatë një periudhe 1 vjeçare, për menaxhimin e portit të peshkimit ose markatës në varësi të objektit që transferohet. Vlera që do të konsiderohet për efekt konkurrimi do të jetë vlera totale e shpenzimeve të nevojshme për gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes.

7. Në rast se në procedurën e konkurrimit paraqitet vetëm një konkurues, komisioni që do të shqyrtojë dokumentacionin, do të propozojë transferimin e menaxhimit të infrastrukturës, vetëm në rast se plan menaxhimi është në përputhje me qëllimin e transferimit, që nënkupton shërbim të një cilësie të lartë dhe me kosto operative të ulët, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes.

8. Në rastet kur në procedurën e konkurrimit të sipërcituar marrin pjesë më shumë se një konkurues vlerësimi do të bëhet në zbatim të metodologjisë të vlerësimit të kritereve të konkurrimit si më poshtë:

- Kërkesat do të vlerësohen në bazë të kritereve dhe metodologjisë së vlerësimit dhe fitues do të konsiderohet ai konkurues, që ka numër më të lartë të pikëve, në bazë të kritereve të vlerësimit.

- Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, i krijuar në zbatim të urdhrit të ministrit, sipas VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019, do të vlerësojë kërkesat, duke u bazuar në:

a) kriteret e përcaktuara në pikën 24, të kreut V të VKM-së; dhe

b) pikët e shpallura në konkurrim, duke vlerësuar plan menaxhimin më të mirë me pikët maksimale të kriterit.

- Konkuruesi tjetër do të përfitojë pikët, duke u bazuar në aplikimin e formulës së mëposhtme, për kritetin e parë të konkurrimit (investimi):

$$Pof = \frac{O\ of}{O\ max} \times Pk$$

Detajimi me pikë për kriterin e dytë të komunikimit (plani për sigurinë e infrastrukturës do të bëhet me urdhër ministri, në bazë të pikës 4 të kreut dhe pikës 7 të kreut IV, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 në varësi të objektit që do të transferohet në menaxhim.

Detajimi me pikë për kriterin e tretë të konkurrimit (cilësia e shërbimit) do të bëhet me urdhër ministri, në bazë të pikës 4 të kreut V dhe pikës 7 të kreut IV të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 në varësi të objektit që do të transferohet në menaxhim.

Për të vlerësuar kriterin e katërt të konkurrimit (kostot operative), do të aplikohet formula e mëposhtme:

$$Pof = \frac{O\ min}{O\ max} \times Pk$$

Pas përcaktimit të pikëve të vlerësimit për secilin kriter bëhet përllogaritja totale e pikëve si më poshtë:

Pt = P1+P2 +P3+P4

Ku:

Pof- pikët që përfiton ofertuesi

Oof- ofertë e ofertuesit

Omax - oferta që ka fituar pikët maksimale

Omin- oferta që ka fituar pikët maksimale

Pk- pikët për kriter që do të përcaktohen në urdhër të ministrit rast pas rasti

Pt- pikët totale

P1, P2- Pikët për kriterin e parë, të dytë e në vijim.

9. Kriteret e përcaktuara në pikën 24, të kreut V, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 do të vlerësohen me pikët e mëposhtme:

- investimet e parashikuara 25 pikë;
- plani për sigurinë e infrastrukturës25 pikë;
- cilësia e shërbimit25 pikë;
- kosto operative 25 pikë.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoria përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 274, datë 19.7.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE, TRAJNIMEVE, WORKSHOPE-ve JASHTË VENDIT, PËR NËPUNËSIT E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE INSTITUCIONET E VARËSISË

Në bazë të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kreut II, neni 28 "Për delegim kompetence dhe zëvendësim të tyre të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013 të ministrit të Financave, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit",

URDHËROJ:

1. Miratimi i shërbimeve, trajnimeve dhe Workshope-ve jashtë vendit, për punonjësit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë, të bëhet nga zëvendësministri përkatës, kompetencat e të cilëve janë të përcaktuara në urdhrin nr. 43, datë 11.2.2019, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Mbi caktimin e fushave të përgjegjësisë dhe detyrave kryesore të Zëvendësministrave të MFE-së".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në MFE dhe institucionet në varësi të saj.

3. Urdhri nr. 5, datë 4.1.2019, "Për delegimin e kompetencave për miratimin e shërbimeve jashtë vendit për punonjësit e MFE-së dhe institucionet e varësisë", shfuqizohet .

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 436, datë 26.7.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar, vendimit nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", kreut IV "Kriteret e përcaktimit të vlerës minimale të qirasë së tokës bujqësore shtetërore", të udhëzimit nr. 12, datë 30.7.2018 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, "Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Qiradhënies, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, kriteret e vlerësimit dhe mënyra e përllogaritjes së ofertave, si dhe kriteret dhe mënyra e llogaritjes së vlerës së qirasë, në procesin dhe marrjen me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të kontratave të qirasë së tokës bujqësore, në pronësi të shtetit, në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), në vijim të urdhrit të ministrit për miratimin e lidhjes së kontratës, z. Enea Hoti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MBZHR-së.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 90, datë 16.7.2019

NDIHMA SHTETËROR "FONDI GRANT 'PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË KONVIKTET E STUDENTEVE' TË BASHKISË TIRANË"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Anila Denaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Etleva Haka	anëtare;
Znj. Mirjana Zisi	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 16.7.2019, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", mori në shqyrtim njoftimin e ndihmës së kryer nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me fondin grant "Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve" të Bashkisë Tiranë.

I. Procedura

1. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me shkresën nr. 5331, datë 17.5.2019 "Kërkesë për miratimin e ndihmës shtetërore për fondet 'Grand' për përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë", kërkon miratimin e grantit pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore. MFE-ja, me shkresën nr. 9407/1, datë 30.5.2019, i kërkoi MASR-së njoftimin e planit në përputhje më nenin 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, të shoqëruar me Formularin Bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore të përcaktuar në aneksin 1 të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'". MASR-ja me shkresën nr. 5331/1, datë 21.6.2019, dërgoi në MFE njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i njoftuar synon përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë për vitin 2019, duke transferuar fondet nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Baza ligjore: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 13.3.2019 "Për procedurat e transferimit të fondit grant 'Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve'", të Bashkisë Tiranë, pika 2, parashikon që:

"Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te përfituesi, ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve, me pronar Bashkinë Tiranë, si transfertë në llogarinë e përfituesit në bankën e nivelit të dytë".

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

4. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembëroje konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

5. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374/2005, zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik dhe selektiviteti dhe c) efekti në konkurrencë / tregti.

Skema e njoftuar aktivizon burime shtetërore nga buxheti i shtetit (Programi buxhetor "Arsimi i Lartë"). Përfitues i fondeve të MASR-së është Bashkia e Tiranës, që në kuptim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2015 "Për ndihmën shtetërore", nuk konsiderohet një "ndërmarrje" me veprimtari ekonomike[1].

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se masa e njoftuar nuk përbën ndihmë shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Fondi Grant "Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve" të Bashkisë Tiranë, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për vitin 2019, nuk përbën ndihmë shtetërore.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

KËRKESË

Shtetasit Bilal Ramaliu dhe Haxhi Ramaliu, kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deklarimin si person të zhdukur të shtetasit Elmaz Ramaliu, i lindur në vitin 1940.

KËRKUES
Bilal dhe Haxhi Ramaliu

[1] Neni 3, pika 2, e ligjit nr. 9374/2005: "Ndërmarrje" është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë